

“... Ç’është Shqipëria e tregon më shumë një kullë malësore, se të gjitha bulevardet e kryeqytetit” - **Indro Montanelli**



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 133, nëntor 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

THIRRJE

Të nderuar anëtar e anëtare të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”!

Të nderuar dukagjinase e dukagjinase kudo që ndodheni, në Dukagjin, në Shqipëri dhe jashtë saj!

Të nderuar miq e mikeshatë Dukagjinit dhe të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”!

Kam kënaqësinë dhe detyrimin që t’ju bëj të ditur sa më poshtë:

Kryesia e Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së atdhetarit Mehmet Shpendi dhe 90 vjetorit të lindjes së albanologut Martin Camaj, ndër-mori nismën që këtyre personaliteteve të nderuara dukagjinase, këtyre luftëtarëve të pushkës dhe pendës, të cilët vunë në shërbim të krahinës dhe gjithë Shqipërisë dijen, mundin dhe gjakun e tyre, tu ngremë përmendoret e tyre, në bronz, në qytetin e Shkodrës. Ne jemi dhe duhet të jemi krenarë që i kemi këto personalitete, që, emri dhe vepra e tyre tashmë është e njohur edhe në qarqet Evropiane, përmendoret e të cilëve do të bëjnë nderë Dukagjinit dhe dukagjinaseve kudo që janë, Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë.

Për këtë i bëmë propozimin Këshillit të Bashkisë së qytetit Shkodër për të pranuar dhe miratuar vendosjen e tyre. Mbi bazën e këtij propozimi, me Vendimin Nr. 74, date 12 nëntor 2014 dhe Nr. 82, date 27 nëntor 2014 të Këshillit të Bashkisë Shkodër, miratohet leja e vendosjes së këtyre dy monumenteve (statujave) brenda qytetit të Shkodrës. Këto monumente do t’i realizojnë skulptori i talentuar, Skënder Kraja, i cili ka realizuar bocetin (projektin) e tyre me shumë cilësi dhe frymëzim.

Përmendoret janë madhore, në këmbë (2. 5 m e larte + 0.6 m bazamenti i vendosjes se tyre = 3. 1 m e larte) dhe pasqyrojnë jetën dhe mendimin e tyre.

Vlera për ndërtimin e këtyre përmendoreve është:

1. Për përmendoren e atdhetarit Mehmet Shpendit shkon në 41 900 €.

2. Për përmendoren albanologut Martin Camaj shkon në 39 400 €.

Shuma e përgjithshme për të dy përmendoret shkon në 81 300 €.

Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”, si shoqatë plotësisht vullnetare dhe pa asnjë llogari rrjedhëse, e ka të pamundur realizimin e këtyre përmendoreve në pikëpamjen finan-

ciare. Prandaj u bëjmë thirrje të gjithë bashkëkrahinarëve tonë, kudo që punojnë dhe jetojnë, miqve të Dukagjinit dhe të Shoqatës, që të mundësojnë realizimin e kësaj detyre atdhetare. Gjithsecili sipas mundësive, sipas zemrës dhe xhepit. Nga të gjithë, sipas mundësive, do të bëhet e mundur realizimi i këtij misioni, për të cilin brezat e ardhshëm do të na jene mirënjohës. Për grumbullimin e fondeve për këto përmendore janë hapur numrat e llogarisë pranë llogarisë së Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, në UNIONBANK, dega Shkodër, në euro, dollar dhe lek:

Numri i llogarisë në Shoqatës “Atdhetare - Dukagjini” në lek: 510367047020112

Numri i llogarisë në Shoqatës “Atdhetare - Dukagjini” në euro: 510367047020123

Numri i llogarisë në Shoqatës “Atdhetare - Dukagjini” në dollar: 510367047020145

Për të dhuruar fonde financiare duhet të veprohet në këtë mënyrë:

P.sh, në lek: SHOQATA ATDHETARE DUKAGJINI - 510367047020112, për llogari të përmendores së Mehmet Shpendit, ose për llogari të përmendores së Martin Camajt. Në këtë mënyrë veprohet edhe në euro, edhe në dollarë. Pra dhuruesit është mirë që të përcaktojnë për cilën përmendore e bëjnë dhurimin. Të gjithë dhuruesit janë të lutur që të ruajnë mandatet e arketimeve, në çfarëdo monedhe qofshin.

Për administrimin e llogarisë, në të tri monedhat, përgjigjet seksioni i ekonomisë dhe financës i Shoqatës, i cili në çdo javë informon kryesinë e shoqatës për sasinë e mbledhur. Shoqata do të mundësojë të gjithë mekanizmat për evidentimin dhe menaxhimin e plotë dhe me përgjegjësi e transparencë, gjë e cila do të bëhet publike, herë pas here, apo edhe kërkesë personale apo kolektive të dhuruesve. Do të evidentohen të gjithë dhuruesit dhe do të publikohen së bashku me sasinë e dhuruar periodikisht në gazetën “Dukagjini”, në faqen e internetit të shoqatës, në faqen e facebook të Shoqatës e kudo që paraqitet mundësia, si një vlerësim e respekt për ta.

Të dashur vëllezër dhe motra dukagjinase!

Të dashur dashamirës të Dukagjinit dhe dukagjinaseve!

Është e domosdoshme që të bëhen të gjitha përpjekjet që brenda muajit janar 2015, të grumbullohen fondet e duhura, me qëllim që ti jepet koha e domosdoshme skulptorit për të punuar dhe të dorëzohen përmendoret në kohën e caktuar. Përmendoret duhet të jenë të përfunduara brenda muajit maj 2015.

NDUE SANAJ

KRYETARI I SHOQATES “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Shkodër, me 2 dhjetor 2014

MIRËNJOHJA PËR LUFTËN NÇL ËSHTË RESPEKTI PËR HISTORINË

Kur terri i pa dijes dhe mjerimit, endej si **2** flama- një më Shqipërinë e vogël e hallemadhe Kur shqiptarja dhe flamuri ynë kombëtarë kishin rënë trishtueshëm në thundrat e luanit që kishte varrosë për se gjalli independencës tonë rinore 27 vjeçare. Kur helmi i mërisë i mbjellë nga dinakëria e pushtuesve nazi-fashist u’ a kishte kapërthyer zemrat e shqiptarëve duke i ndarë në mes njeri-tjetrit në hendeqe të thella. Fronti NÇL ishte refreni më përbashkues i fjalës ëmbëltoje liri, për kush pati veshë për ta dëgjuar, sy për ta pa dhe zemër për ta dashur. Lufta NÇL ishte flaka e zjarreve shekullare të pa shuara atdhetare ishte kushtrimi kumbues i ditës së tretë më fatlume të kombit tonë.(nëntorit të tretë) i asaj dite që fat-keqësisht mbaroi tepër shpejt më një përdim të përgjakur duke lënë pas natën e një robie te re.

FIGURA E PREND DOÇIT, ABATIT TË MIRDITËS

NË MONOGRAFINË E Dr. LUIGJ MARTINIT - Vlerësimi dhe rivlerësimi i figurave të shqueme të historisë sonë, të cilat, falë kontributeve madhore që dhanë në periudha të ndryshme të zhvillimeve tona historike të luftërave e përpjekjeve për liri, pavarësi e çlirim shoqnor, ka qenë dhe mbetet një detyre e randësishme e historianeve dhe jo vetëm e tyre. Aq ma emergjent bahet një detyrim si ky, kur ndjehet ende kaq shume nevoja me vu në vendin e vet të vërtetat tona historike të mohueme a të shtremnueme nga historiografia komuniste e pseudohistorianëve tendenciozë e nostalgjike politike të asaj së shqueme, që kane guximim ende sot me mbrojtje mendësitë e veprën e tyre spekulante që deformoi qëllim

8

STANI: KOSTOJA E LIRISË ËSHTË E RËNDË NË ÇDO KOHË

BISEDË E SHKRIMTARIT LAZËR STANI ME POETEN DHE PROZATOREN ALBANA SHALA Lazër, si pa e kuptuar u rritem, u maturuam, u bëmë prindër e bashkëshortë, dajallarë e xhaxhallarë, pronarë tokash apo shtëpish, nënpunsa, shefa, këshilltarë, kryetarë. A janë këto përkatësi të jetës, që ti i ke dashur apo ëndërruar?

Ligji i jetës dhe koha e pamëshirshme e bëjnë të vetë **3** shndër-rojnë në secilën ditë që jetojmë. Njeriu nuk e mban në mirë kur ka filluar ta projektojë ëndrrën e vet...

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION Produzione Giacche



MIRËNJOHJA PËR LUFTËN NÇL ËSHTË RESPEKTI PËR HISTORINË

Kur terri i pa dijes dhe mjerimit, endej si mjegullnajë më Shqipërinë e vogël e hallemadhe Kur shqijonja dhe flamuri ynë kombëtarë kishin rënë trishtueshëm në thundrat e luanit që kishte varrosë për se gjalli independencës tonë rinore 27 vjeçare. Kur helmi i mërisë i mbjellë nga dinakëria e pushtuesve nazifashist u' a kishte kapërthyer zemrat e shqiptarëve duke i ndarë në mes njeri-tjetrit në hendeqe të thella. Fronti NÇL ishte refreni më përbashkues i fjalës ëmbëltoje liri, për kush pati veshë për ta dëgjuar, sy për ta pa dhe zemër për ta dashur. Lufta NÇL ishte flaka e zjarreve shekullare të pa shuara atdhetare ishte kushtrimi kumbues i ditës së tretë më fatlume të kombit tonë,(nëntorit të tretë) i asaj dite që fatkeqësisht mbaroi tepër shpejt më një perëndim të përgjakur duke lënë pas natën e një robie te re. Lufta NÇL nuk duhet nderuar dhe respektuar në mënyrë të një anshme si deri dje vetëm pse atë e udhëhoqën komunistët dhe pse ajo drejtohej kundër fashistëve, as siç tentohet të nxihet dhe të mallkohet sot. Luftën e bëri populli shqiptar. Merita e komunistëve qëndron në udhëheqjen e luftës dhe në refuzimin e çfarëdo kompromisi politik të dhuruar nga pushtuesit e vendit . Lufta do të mbetej po kaq lavdishme edhe sikur ta kishte drejtuar një formacion tjetër politik, edhe sikur të drejtohej kundër çdo pushtuesi të kuq, të zi apo bardhë. Edhe sikur Aleanca Antifashiste Botërore të humbte luftën , vlerat e LANÇL nuk do të humbnin, sepse ajo ishte një luftë e drejtë, çlirimtare bekuar me gjakun në lules më të mirë të djelmisë shqiptare. LANÇL duhet vlerësuar se Shqipëria dha kon-

tributin e saj serioz dhe të merituar (në raport me popullsinë), në kuadrin e ballafaqimit midis dy botëve, asaj të shtypjes dhe asaj të çlirimit kombëtar. Vlerat kryesore të luftës nuk qëndrojnë thjesht në numrin e dëshmorëve (që paturpësisht i kemi përgojuar dhe plotpjestuar më katër) apo në madhësinë e betejave. Vlera embrionale e saj qëndron në faktin se në u rreshtuam në kohën dhe krahun e duhur të Aleancës së më të madhe progresive dhe fitimtare që kishte njohur historia. Vaj medet se sikur gjithë shqiptaret në kishin rënë prehe parullës demagogjike të Shqipërisë së madhe dhe bashkëpunonin me pushtuesit. Atëherë pas luftës zor se do gjej kush të bënte avokatin e djallit . Zor se do na kishte shpëtuar as kush nga oreksi i fqinjëve që ishin pjesë e Aleancës Antifashiste, e cila rezultoi fituese, dhe territori i shtetit shqiptar do të cungohej akoma më shumë. Fitimtarët që ndanë Gjermaninë nuk do të mendoheshin dy herë që të kënaqnin aleatët e vet në kurriz të një " ish dashnorja budallaqe " të Gjermanisë. Vlera e dytë e luftës qëndron në faktin se shmangu paraqitjen e shqiptarëve para bashkësisë së kombeve si një popull pa dinjitet që i përkulet, i shërben dhe i nënshtrohet cilitdo pushtues që i hyn në shtëpi pa trokitur. Lufta ANÇ Ishte një autokritikë ndaj qëndresës qesharake te 7 prillit 1939 ku çdo gjë atë të

premtë zezë filloj dhe përfundoj brenda disa orëve, vetëm më një dëshmorë të vetëm Mujo Ulqinakun. Populli shqiptarë për herë të parë pas betejave



historike Gjeorgjiane në valën e qëndresës antifashiste krijoi një ushtri të rregullit funksionale me strukturë dhe hierarki solide të farkëtuar në zjarr dhe të larë më gjakun e mijëra rënëve moshatarë më pranverën. Me heroi të tillë si Vojo Kushi, Tre heroit e Shkodrës, Manush Alimani, Margarita Tutulani, Hajdar Dushi, Asim Zeneli etj etj. do të krenohet çdo komb edhe dhjetëra milionësh. LNÇL

mbetet e rëndësishme sa për të shkuarën po aq edhe për të sotmen dhe të ardhmen, sepse është kriteri moral me të cilin edukojmë brezat. Vetëm një popull që nderon luftëtarët e lirisë kombëtare dhe përçmon puthadorët e pushtuesve mund të radhitet me dinjitet në familjen e kombeve.

Ne nderojmë dhe u ngremë varreza ushtarakëve të huaj që ranë në tokën tonë por, nga ana tjetër, dhuniam varret atdhetarëve të flijuar shqiptarë. Ne sot me dy fytyrësi, nga njëra anë e quajmë krenari dhe nderojmë dërgimin e ushtarëve tanë përkrah forcave të NATO-s , por nga ana tjetër përçmojmë dhe fyejmë bijtë dhe bijat tanë më të mirë që dhanë jetët e tyre për këtë Shqipëri që kemi sot Të krekosesh si llasticë duke i rënë gjoksit si anëtare e NATO-s , ku luan rolin figurantit dhe, nga ana tjetër, të mohosh dhe fyesh pjesëmarrjen aktive dhe konkrete në fushën e luftës kundër armiqve të përbashkët pushtues, siç ishte Aleanca Antifashiste e Luftës së Dytë Botërore, kjo do të thotë të tallesh me historinë, me të vërtetën por edhe me popullin tënd. Megjithëse kanë kaluar afro 70 vjet nga përfundimi i Luftës Dytë Botërore, në të gjithë botën përkujtohet me madhëstini që i takon, fitorja mbi nazi-fashizmin. Dhe kryesorja, respektohen dhe vlerësohen në shkallën më të lartë ata që e bënë luftën. Në Shqipëri ky 70 vjetor po kremtohet pa bujë të pa zhurmë, por prap se prap nuk mungojnë shashkat antikomuniste si mbetje kolaboracionizmit djeshëm. Në këtë 70 vjetor Dukagjini ka të drejtë të ndihet krenarë për kontributin e bijve të tij më të mirë në

Luftën ANÇ. Një çetë partizanë, antifashiste aktive dy kompani bazamentale të Batalionit Perlat Rexhepi me një pjesëmarrje mbi 150 vetë në prag të çlirimit në formacionet e UNÇ

Dihet se disa krahina, veriore nuk u përfshin në Luftën Nacional Çlirimtare në atë shkallë që e kërkonin interesat e atdheut, ndonëse që në të kaluarën ishin dalluar në kryengritjet e luftëtar popullit tonë kundër pushtuesve osman e serbo - malazez. Nuk ngjau kështu me Dukagjini i cili si në çdo kohë u orientua drejt me vetë dije në kahun më progresiv të kohës. Ishte një fat qenia në krye të kësaj lëvizje e një personaliteti mendje ndritur, patriot dhe demokrat si Profesor Kolë Prela i cili mblodhi rreth vetës një armatë të terë atdhetarësh si Gjon Marashin, Bal Marku, Gjesh Lushi Market Pjetrin, Ndue Sokolin, Pjetër Gjergji, Prekë Sokoli, Mëhill Lulashi, Ndue Micani, Ndokë Gjeshi, Martin Gjoni, Prelë Binaku, Pjetër Biba, Pjetër Prelashi, Nikë Sytani, Vat Gjeshi . Pellumb Noka, Zef Sokol Shytani, Bal Dema, Martin Cama, Tomë Kola, Mirash Zefi, Marsh Vogli, Kurtesh Kurti Martin Coli, Gjin Rustemi, Zef Marashi, Mushak Deda, Nikol Prekë Prenashi, Prelë Mëhilli, Gjon Sokoli etj. Flamuri ynë i bekuar i ushqyer me gjakun e fatosave nder shekuj u njom përsëri me gjakun ngrohtë djalosharë të Tom Kolës, Vat Lulit, Gasper Shoshit, Martin Kolës, Kol Markut dhe Ndue Gjeshit që ranë për këtë tokë të shenjtë, duke bashkangjitur çetës së pa vdekshme të dëshmorëve. Mirënjohje gjer në përjetësi për ju që na dhuruat një faqe bardhësi historike të tillë me vlera kombëtare dhe evropiane. Nga Prele Milani

Një fëmijë shqiptar vlerësohet me diplomë nga Microsoft dhe Facebook

Fituesi i kësaj diplome stimuluese për programet kompjuterike, është një fëmijë shkodran, vetëm 13 vjeç. Është një program me kode përmes blloqeve që është shtrirë në shkollat amerikane e më gjerë, deri në universitetin e Harvardit etj. Organizohet nga liderit botëror të prodhimit të softëve/programëve si Bill Gatës i Microsoft dhe Mark Zukenberg i Facebook etj. Programet janë më të avancuarat. Ky program ishte për tu zgjidhur nga 20 kode deri ne gjashte kode qe ishte rezultati me i mire i mundshëm. Nilidon Pepushaj, vetëm 13 vjeç, nxënës në klasën e 7-të të shkollës jopublike 'Zemra e Krishtit' në Shkodër, arriti ta realizoi programin me pikët maksimale, me gjashte blloqe. Pjesëmarrja ne këtë konkurrim, ose orë mësimi siç i quajmë drejtuesit e tyre, u zhvillua përmes internetit dhe 13 vjeçar u vlerësua me këtë diplomë.

I urojme e të tjera, por kjo është esenca. Mund te shtosh çka duam vete. Gjithë te mirat.



STANI: Kostoja e lirisë është e rëndë në çdo kohë

BISEDË E SHKRIMTARIT LAZËR STANI
ME POETEN DHE PROZATOREN ALBANA SHALA

Lazër, si pa e kuptuar u rritem, u matuam, u bëmë prindër e bashkëshortë, dajallarë e xhaxhallarë, pronarë tokash apo shtëpish, nënpunsa, shefa, këshilltarë, kryetarë. A janë këto përkatësi të jetës, që ti i ke dashur apo ëndërruar?

Ligji i jetës dhe koha e pamëshirshme e bëjnë të vetën; na shndërrojnë në secilën ditë që jetojmë. Njeriu nuk e mban mend mirë kur ka filluar ta projektojë ëndrrën e vet, nuk është i sigurtë, nëse e ka trilluar apo ka lindur me një ëndërr të shkruar në genet e tij dhe dalëngadalë, në çastin që vetëdijësohet për të, i qepet pas, përpiqet, mundohet, rropatet, nuk i ndalon kurrë orvatjet që ta mbërrijë. Po ajo është gjithmonë e largët dhe e paarritshme, sado të ngajë se i je afuar dhe për një grimë mund ta prekësh. Është si loja e qiellit me kreshtën e malit në horizont. Thua me vete se sa ta ngjitem në kreshtë do të prek qiellin, por, sapo ngjitesh në majë, e kupton se qielli ia ka mbathur tutje te kreshta tjetër. Diku kam thënë njëherë se njeriu nuk mund t'i shkapërcejë ëndrrat e tij. As në letërsi, as në jetë. Midis ëndrrës dhe jetës gjithmonë ka një ndryshim nivelesh; jetojmë në një nivel më të ulët se sa ëndërrojmë dhe kjo na bën të mos i ndalojmë përpjekjet tona sa ta kemi frymën. Dhe të mos e humbasim shpresën gjithashtu.

Di vetëm se ëndrrat e mia kanë gjënë gjithmonë të lagëta, nuk ndaleshin te rrëza e parë e kodrës përballë shtëpisë, të faqja e malit kundruall apo brenda çadrës që krijonte horizonti i ulur në kurorën e kreshtave që rrethonin vendlindjen time. Njëherë madje me një moshatarin tim qesh ngjitur në majën me të lartë dhe prej aty shikoja horizontin e zgjeruar deri ku humbiste vështrimi, tutje liqenit të Shkodrës e deri në Adriatik. U pushtova nga një ndjenjë madhështore, një gufim triumfi shpirtëror. Me sa duket gjithmonë me kishte mundur trysnia e një horizonti të ngushtë. Si nxënës isha i dashuruar pas hartave. Udhëtoja në harta në të gjitha anët e rruzullit, nga Arktiku në Polin e Jugut, duke i shkelur me mendje pëllëmbë për pëllëmbë, qytetet, fshatrat, malet e fushat e kësaj toke. Dhe kur bota më dukej e vogël, ktheja sytë nga qielli dhe vështroja yjet e largët. Atëbotë kuptova se vetmia ishte ligji universal i kozmosit, se ylli më i afërt ishte mijëra vite dritë larg dhe se yjet gjithashtu ishin të dënuar me vetmi të përrjetshme. Nuk e kuptoja pse krijuesi i Universit na kishte dënuar me këtë vetmi të pandreqshme. Vite më vonë u binda se vetmia nuk është ligj vetëm në univers, po edhe brenda nesh, e shkruar në genet tona dhe në përpiqemi të çlirohemi prej saj me të gjitha mjetet tona, pa ia dalë kurrë mbanë. Këtu zë fill edhe letërsia, veç të tjerash.

Ah, të kthehem më konkretisht të pyetja juaj. Në këtë betejë të vazhdueshme, që përthehet ndryshe në vite të jetuar, kam arritur shumë gjera, jam shkolluar,



bërë një shtëpi për vetën dhe familjen, martuar, rritur fëmijë, përcjellë për në atë botë njerëz të dashur, shkruar libra, lënë disa dëshmi. Por siç e thashë me lart, ëndrra gjithnjë largohet si horizonti, është gjithmonë në kreshtën tjetër dhe kjo është një nxitje për të jetuar edhe më tutje.

Çfarë të ka bërë të lirë e të përveçëm përpara 40 vjetësh, 20 vjetësh, çfarë të bën sot?

Edhe unë e kam menduar shumë herë me vetën këtë gjë: çfarë më ka bërë njeri të lirë? I kam dhënë përgjigje të ndryshme kësaj pyetjeje në vite të ndryshme, por gjithnjë duke mbetur te bindja e hershme: njeriu lind me lirinë e tij. Tjetër është vetëdija e lirisë, tjetër guximi për ta mbrojtur lirinë tende gjithnjë të kërcënuar. Ne jemi rritur në një kohë të keqe për lirinë, nën një diktaturë nga më të egrat e imagjinueshme. E megjithatë them se kam qenë njeri i lirë. Pikërisht për këtë kam shkruar dhe një tregim për këtë me titullin "Idioti udhëton për Amerikë".

Kërcënimit më të madh ndaj lirisë sime individuale në rininë time i bëra ballë me idenë e arratisjes. Në momentet kur qëndroja para hartave, unë nuk mund ta kuptoja se përse nuk mund ta shkelja një vend, vetëm pse atje jetonte një popull tjetër, i përkiste një shteti tjetër. Toka është e njeriut, jo e qeverive apo diktatorëve që ngrenë gardhe, mure të pakalueshme. Ideja e arratisjes te unë ka qenë shumë e hershme edhe pse nuk u arratisa kurrë. Ishte një sekret që më sillte ngazëllim, më zbulonte mundësi të pafundme. Ajo më bënte t'i qëndroja larg realitetit, të mos i kushtoja asnjë kujdes karrierës time të ardhme në vendin ku jetoja. Jetoja me vetën time dhe për veten time. Më kujtohet ankthi dhe tundimi i një dite tetori, ndërsa rrija në bregun e këtejme të Bunës. Në bregun tjetër, atë të përtejmin, gjendej një kishë e vjetër, e braktisur më dukej, ndërsa këtë kishat

ishin rrafshuar me tokën. Mjafton të no-toje njëqind metra dhe gjendeshe përtej kufirit, në botën tjetër, të mistershme dhe të panjohur. Pak më tutje mbi bregun e ngritur rrinin duke u ngrohur në diell tre ushtarë, ruajtës së kufirit, të qetë, të qeshur, lozonjarë. Dhe ta mendosh se ata djem mund të shndërroheshin në vrasës të pamëshirshëm, sapo dikush të provonte të hidhej në ujë, në tentativë për të mbërritur bregun tjetër, bregun e huaj. Bënte shumë ftohtë, toka rrotull kishte ngrirë. Unë ngrohsha me idenë se një ditë do ta kaloja këtë kufi, gjallë a vdekur. U ktheva prapë te puna e detyruar - zhveshja e misrit - me një ngazëllim që më kishte pushtuar shpirtin, i ngjashëm me ngazëllimin e dashurisë së parë. Këtë të fshehtë timen e ndava më vonë me mikun tim Ndoc Dedën (Shtëpinë) dhe për shumë vite, me orë e net të tëra diskutonim idenë tonë të arratisjes, thurnim plane pas planesh, të bindur se nuk kishim rrugë tjetër. Pasi morëm diplomat universitare, ajo që na ndaloi ishte gjyshi im i sëmurë. I premtova Ndocit se kur gjyshi të mos ishte më gjallë, unë do të arratisesha se bashku me të në vjeshtë të parë. E doja aq shumë tim gjysh sa nuk mund ta braktisja në asnjë rrethanë. Kur ai u nda nga kjo jetë, një vit më vonë miku im u arratis, ndërsa unë mbeta këtu, për të mos u arratisur më kurrë, se kufijtë ranë dhe në një farë mënyre liritë politike u vendosën. Arratisja nuk kishte më kuptim.

Por instinkti i lirisë, kështu po e quaj, nuk funksionon vetëm në një drejtim. Ka plot njerëz jo të lirë në shoqëritë e lira. Unë them se kam qenë dhe jam njeri i lirë, duke paguar për këtë një çmim të vazhdueshëm. Kostoja e lirisë është e rëndë në çdo kohë e në çdo shoqëri, por vetëm ndjesia e lirisë e bën këtë jetë të jetueshme.

Sa shqiptar ndihesh dhe je Lazër Stani?

Ndihem krejtësisht shqiptar, sepse as kam, as mund të kem identitet tjetër dhe po të dua. Vij nga një familje shqiptare e krishterë brez pas brezi, prej kohësh që nuk mbahen mend. Shkruaj shqip, flas shqip, jam lindur e rritur në Shqipëri, çfarë mund të jem tjetër? Natyrisht të qenit shqiptar nuk është zgjedhje: thjesht kam lindur shqiptar, në pasaportën time dhe në kartën time të identitetit shkruhet "Albanian". A ka kjo një domethënie? Prapa kësaj fjale me tetë shkronja, natyrisht qëndron një domethënie. Edhe një i huaj, kur lexon këtë fjalë në pasaportë përpiqet të deshifrojë këtë domethënie, vë në lëvizje njohuritë e tij të gjeografisë, të historisë, ose njohuritë e freskëta që mund t'i vijnë nga ndonjë lajm i botuar në gazetën e ditës. Por mua nuk më shqetëson kjo domethënie sipërfaqësore që në fund të fundit nuk tregon gjë hije.

Njeriu është shumë me tepër se një nocion gjeografik. Është një histori personale, e përvetësime, e pakrahasueshme me historinë e askujt dhe e papërsëritshme kund tjetër. Njëpërmjet ngjashmërive dhe përgjithësimeve gjithmonë nxirren përfundime mediokre, në mos të gabuara. Për mua domethënia të qenit shqiptar është krejt tjetër: është historia ime dhe e familjes time, janë fjalët që kam pëshpëritur së pari, janë të parët që prehen ndër varre, është kultura dhe historia, mitet, legjendat, ëndrrat, është projekti i një jete.

Sa evropian, sa qytetar global village (i fshatit global)?

Emërtimet gjeografike nuk kanë ndonjë kuptim për njeriun. Jam shqiptar dhe jam evropian njëkohësisht. Evropianët mbase e bëjnë, po unë nuk di të bëj ndonjë dallim midis vetes dhe tyre në asnjë pikëpamje. Qytetërimi evropian i ka rrënjët te qytetërimi mesdhetar greko-romak dhe tek vlerat e krishterimit. Si shqiptar, them se vij nga një popull që ka qenë i shkriër me këto dy qytetërimi, që ka marrë dhe ka dhënë me to, që ka dhënë jo vetëm perandorë, Papë e komandantë të shquar ushtarakë, por edhe fjalë të fillësës, kulturë, mite, legjenda, histori. Mesjeta solli një dramë të madhe për shqiptarët, po nuk mendoj se arriti ta zhbëjë genin shqiptar, arketipin shqiptar, evropian njëkohësisht. Por sigurisht nuk të bën vetëm vendlindja evropian: të bën kultura, sistemi i vlerave të pranuar evropiane. Nëse gjykojmë nga preferencat letrare atëherë nuk kam nacionalitet, ose nacionaliteti im është njerëzimi. Në tryezën time të shkrimit janë gjithmonë dy libra me poezi të Borhesit: L'oro dei tigri dhe "Night poems"; "Selected poems" nga Yehuda Amichai, "Lavorare stanca" nga Cesare Pavese, "Tutte le poesie" të Salvatore Quasimodo-s, "Collected poems" të C. P. Cavafy-s tregime të Singerit, Amos Oz-it, Julio Cortazar-it, tregimet e Roberto Bolanos, Franz Kafkës e shumë autorëve të tjerë, që përbëjnë bibliotekën time të dashur, e cila ka vetëm një identitet-kulturë e njerëzimit. Dhe unë sigurisht që e ndjej vetën pjesë të kësaj kulture, më shumë se gjithçka tjetër.

Çfarë mendon për të ashtuquajturën "citizenship"-ndjenje qytetarie...?

Qytetërimi shqiptar dhe ndjenja e qytetarisë ka marrë dy goditje vdekjeprurëse në Histori, një në mesjetë dhe një në vitin 1944 me vendosjen e sistemit komunist. Nëse hulumtojmë qytetërimin shqiptar paraosman, shikojmë se qytetet kryesore shqiptare si Shkodra, Durrësi, Drishti e te tjerë, janë me të zhvilluar se fqinjët. Mjafton të lexosh Statutet e Shkodrës dhe të Drishtit dhe bindesh për këtë. Të mos harrojmë pastaj se në Obot të Shkodrës u montua një nga dhjetë shtypshkronjat e para në botë. Pastaj u dynden osmanët dhe gjithçka u rrafshua, duke u shndërruar në një provincë të humbur dhe të shtypur barbarisht të perandorisë. Dhe goditja e dytë erdhi nga komunizmi: gjithçka ishte krijuar nga Rilindësit dhe elitat politike e kulturore në shtetin shqiptar gjatë tridhjetë e dy viteve pavarësi, u rrafshua me tokën. Intelektualët, shkrimtarët, institucionet e kulturës dhe të besimit u asgjësuan, duke u zëvendësuar ato me antikulturën e komunizmit, që nuk kishte asgjë të përbashkët me kulturën shqiptare dhe evropiane.

Dhe mbi të gjitha u godit njeriu, vlerat e tij, morali i tij. Kjo i ka krijuar probleme serioze citizenship-it të sotëm shqiptar: në aspektin moral, në aspektin e vlerave, në aspektin e përgjegjësisë, në aspektin e ndjeshmërive. Kam vërejtur se në këtë vend sa më qytetar të jesh, aq më i vetmuar je.

Po ëndrrat, nëse ende Lazër Stani ka ëndrra, cilat janë?

Një herë në ëndërr po lexoja disa tregime që i kisha shkruar vetë. Më magjepsën. Ti shkruaj një ditë ato tregime, nëse mundem.

ZBULIMI I ARKEOLOGEVE -KISHA ROMAKE E SHEKULLIT IV NË ULPIANËN DARDANE

Hyrje

Pikësëpari, lajmi nga gazeta turke Hyrjet (Daily Nees), një ekip arkeolog turk i kryesuar nga Prof i universitetit të arteve të bukura "Mimar Sinan", Haluk Cetinkaya ka gjetur gjurmë të një kisha romake nga shekulli i katërt p. e. r në kryeqytetin kosovar të Prishtinës. Cetinkaya tha se ata së pari gjetën Pagëzimorja dhe pastaj kanë arritur pjesë të tjera të kishës në vendin e lashtë të Ulpianës, duke shtuar se, shtëpia e adhurimit u rrëzua nga një tërmet në fund të shekullit të katërt para se të rivendoset një shekull më vonë. Kisha është vlerësuar të jetë rreth 19 metra e gjatë dhe do të zbulohet plotësisht vitin e ardhshëm. "Materiali i kishës, monedha dhe skelete të cilat janë gjetur në të janë rëndësishme, pjese e kishës,- tha ai. "Kemi shqyrtuar skelete në laborator dhe kuptova se ato datojnë që nga fillimi i shekullit të pestë. Ne kemi gjetur 101 monedha në zonën e kishës. Pothuajse të gjithë ato janë nga shekulli i katërt. Ky është një kriter i rëndësishëm për takim. Duke marrë parasysh të gjitha këto, ne themi se kisha i përket shekullit të katërt. Nga ana tjetër, përdorimi i kryqit ishte e ndaluar në katin e kishave në tremujorin e parë të shekullit të pestë. Këtu, një kryq është përdorur në dyshe, dhe kjo është arsyeja pse kisha daton para shekullit të pestë...".

Punimet filluan me gërmimet në Ulpianë, një nga vendbanimet më të rëndësishme të rajonit në Perandorinë Romake, në vitin 2012 me një marrëveshje të bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës të Kosovës.

1.

Edi Shkriu vlerëson se qyteti 2 mijë vjeçar i Ulpianës dhe shumë objekte tjera trashëgimore nëpër lokalitete tjera, janë pasqyrë me të cilën mund të matet niveli kulturor dhe historik i Kosovës është shprehur arkeologia kosovare.

Tek fytyra e Ulpianës, ne gjejmë një trashëgimi antike ngase kohë-formimi saj ngjet para pushtimit romak me një vijimësi dardane.

Dardanët! Po sjell disa të dhëna ku kam kryer hulumtime: G. Novak Enciklopedia e "lashtë (1966) shkruan: Ulpiana-Qendra romake afër Lipjanit, sot dhe Gračëanica manastir në Prishtinë, mbi Kosovën fushë (Jugosllavia pllajë në kufirin me Shqipërinë), shkatërruar nga zjarri. Justiniani e ka rindërtuar dhe e quajti Iustiniana Secunda, në Gračnica dhe rrethinat e saj janë gjetur mbishkrime dhe palët tjera ruhen në kishën e Gračanices. Pranë Gračanice u zbuluan rrënojat edhe gjera që tregojnë vendin ku ai ishte dikur Ulpiana dhe më vonë Iustiniana Secunda.

-Viale Vittorio, në enciklopedia italiane shkruan: Dardani (Δαρδανεύς, Δαρδάνιοι, Δάρδανοι, Darañni). Njerëzit më klasike ilire që u ndahen kufijtë veriorë të Maqedonisë. Më saktësisht, Dardani zënë dy bankat e sipërme kurse dell'Axius (Vardar) dhe Marava, afërsisht në mes të Head-eaters e Timacus (Timok) në veri-lindje, si dhe ato të Dricon (Drin), në jug-perëndim. Sovrappostisi, ndoshta një popullsi e vjetër, e sllavëruar, dardanët u ndanë në

shumë fise, ndër të cilat më kryesore janë të njohura nga Straboni. Kryesore janë ato të Galabrii dhe Thunatae. Dardanët ishin banorët më të hershëm të Kosovës së sotme.

-Etimologjia e fjalës dardan-shkruan, MA. Sc. Qazim Namani- rrjedhë nga gjuha indoevropiane dardj-a, në gjuhën shqipe dardha (vend i dardhave). Fjala darda është fjalë shqipe që do të thotë dardhë, në trajtën dardan-os del se është sufiks pellazgjik, mbretëria e dardanisë.

-Të parët e tij quheshin ilirë. Thotë prof I. Kelmendi. Këta qenë ndër arianët më të parë që patën hyrje në Evropë. Vendi i tyre quhej Iliri. Fiset ilire: Ilirët kanë qenë të ndarë në fise: Ardianët, Labeatët, Liburnët, Autoariatet, Dalmatët, Dradhanët, Venetët si dhe Mesapët dhe Japuget që banojshin në pjesën e jugut të gadishullit italian. Përveç këtyre kishte edhe fise të tjera. Ky fenomen shpjegohet vetëm me përbërjen dhe natyrën e vendit ku banonin. Ndër fiset e Ilireve, ma i madhi qe fisi i Dardhanëve. Vendi i tyre ishte Kosova e sotme deri në Nish dhe në Jug, në Vardarin e Sipërm deri në agresinat e Manastirit. Kryeqyteti i Dardhanis ishte Shkupi, i cili quhej atëherë Skupi (Scupi). Vihej në dukje bukuria e grave të tyre. Edhe sot ka mbete në Kosovë



Vendi ku behën gërmimet dhe sistemohen objektet

e në vende të tjera, kur duan të ekzaltojnë bukurinë e ndonjë femre thonë: "Qenka si Dardhane".

2.

Ulpiana, dhe pozita gjeostrategjike. Ulpiana, e shquar edhe për pozitën gjeostrategjike, për herë të parë përmendet nga Ptolomeu në shekullin II. Lokaliteti antik romak dhe bizantin i Ulpianës është pa mëdyshje njëra nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjerë të Gadishullit Ilirik, thotë guida arkeologjike e Kosovës. Mirëpo, në Ulpianë sipas studuesve jeta këtu ka filluar më herët dhe gjurmët të shpien në periudhat parahistorike të hekurit dhe bronzi ose e njohur ndryshe si lashtësia dardane. Çfarë sollën pushtimet romake? Kjo pyetje që ngrihet për origjinin e saj saktëson edhe mjaft teza se Ulpiana është një vazhdimësi e qytetërimeve ilir, kryesisht në Kosovë.

3.

Luftërat me Romen. Dardhanet përmenden si luftëtarë të mirë dhe rezistenca e tyre kundër maqedonasve e romakeve është e dëgjuar thotë prof I. Kelmendi. Luftërat me Romen: Në vitin 228 p r Kr u pa zbarkimi i parë i romakeve në Iliri, që sundohej asi kohe në pjesë të madhe prej mbretëreshës Teuta. Lufta nuk përfundoi me një a dy beteja, por zgjati ma shumë

se dy shekuj. Më 168 p r. Kr. konsulli romak Lucius Anicus kaloi si rrëfe nëpër Iliri dhe pushtoi Shkodrën dhe në kështjellën e saj zuri rob mbretin Gencius, të cilin bashkë me të shoqen Etlevën dhe dy të bijtë e dërgoi në Romë, për të stolitur kthimin e tij triumfal. Mbas këtij suksesi Iliria u shpall provincë e Romes. Por në realitet lufta nuk pushoi aspak. Ilirët bëfshin vazhdimisht kryengritje. Sa pushonte a shtypej në njërin ane, kriste në tjetrën thotë prof I. Kelmendi.

4.

Ulpiana mes Romës dhe Kostandinopjës. Të dhënat flasin se kjo qendër bëhet e rëndësishme gjatë periudhës së pushtimit romak. Ka një arsye të gjetur për rëndësinë e saj. Ulpiana gjendej mes Romës dhe Kostandinopjës. Përmendet edhe fakti, që Ulpiana është një kryqëzim. Pra, një pikë ku priten në mes për rrugët që përshkonin nga detet drejt thellësisë. Pra, nga Adriatiku në Egje, në detin e Zi, apo një nyje që takohej pranë Ulpianës-Via LissusNaissus dhe Scupit. Duke ndjekur vijueshmërinë e këtij siti arkeologjik, thuhet se themelimi i saj, që u njoh si qendër komunë Municipium (Ulpianum) besohet të ketë qenë viti vitin 169 e. s. Arritje për këtë sit duhen cilësuar kohët mes shekujt e III dhe IV të e. s. ku zhvillimi i Ulpianës arrit kulminacionet e saj. Kjo pasqyrohet në fushat prioritare, ekonomike, kulturore, zhvillim urban. Zbulimet kanë gjetur objekte, të cilat kanë funksionuar si rrugë, ujësjellës, godina publike. Nga një befasi që mund të zbulohet është se gjatë sundimit të perandorit Justinian, në shekullin VI, kohë kjo kur Ulpiana riemërohet në Justiniana Secunda. Të dhëna për qytetin Ulpiana janë: Ulpiana rrethuar me mure deri në 3 m dhe me nga dy kulla, çdo kulle është 27, 5 m e larte, ka trajtë të parregullt katërkëndëshi. Sipërfaqja prej 35, 5 ha.

5.

Emërtimet që shënojnë Ulpianën. Gjenden disa emërtime të tilla kur flitet për Ulpianën, sidomos për kohë-themelimin e saj.

"Ulpiana është një qytet romak i themeluar në fillim të shekullit II nga perandori Trajan!" Mirëpo kjo tezë nuk mund të pranohet në këtë mënyrë, pasi dëshmitë arkeologjike vërtetojnë një kohë themelimi të saj për romake. Është i vërtetë fakti, që pushtimet romake sollën zhvillime në disa fusha duke kryer transformime të mëdha. Këto zhvillime vihen re në të gjitha trojet dardane, por identifikohet Ulpiana si qendër e zhvilluar dhe më e përparuar. Ajo, që kërkon saktësim është se, në kohën e perandorit Trajan fitoi statusin e qytetit. Një nga të dhënat interesante është fakti se, në mesin e shekullit II në Ulpianë nga administratori dardan Licin ishin flijuar Flori dhe Lauri, dy martirët e përhapjes së krishterimit.

6.

Paganizmi, thotë prof I. Kelmendi, besofshin në shumë perëndi: Medaurus, Binaus, Latra, Seutona e te tjera. Kristianizmi tek ilirët përmend faktin se, ilirët ishin ndër të parët popuj në Evropë që erdhën në kontakt me Kristianizmin. Në vitin 53 Shën Pavli predikoi Ungjillin ndër ilirët,

dhe 4 vjet më vonë nxënësi i tij Titus. Ne shekullin e V-VI, Durrësi dhe Nikopoli u bënë qendrat më të forta të kristianizmit në Iliri. Mbas tyre vinte Shkodra e Tivari. Në kohën e Justinianit, Shkupi u bë kryeqyteti moral dhe administrativ i krejt Ilirisë. Të dhëna të tjera për krishterimin në Iliri gjejmë tek Enciklopedia ku thuhet se: Krishterimi në Shqipëri është ngritur mbi një bazë apostolike. Pozita gjeografike e saj e bën këtë të pashmangshme. Ungjilli i krishterë u fut për herë të parë në Evropë nga apostulli Pal në Filipe të Maqedonisë. Pastaj, duke udhëtuar drejt perëndimit, përmes rrugës Egnatia, ai predikoi në Selanik, qyteti më i madh në atë rrugë. Më vonë, ai u bë qendra nga ku krishterimi rrezatoi mbi Athinë e Korint, si edhe mbi provincën e Ilirikut. Është interesant fakti se si udhëtimet e Palit ndiqnin besnikërisht rrugët romake dhe se si përgjatë tyre shtoheshin zinxhiri i bashkësive të hershme. Me të vërtetë, një udhëtim prej 270 km nëpër rrugën Egnatia, nga Selaniku drejt perëndimit, do të depëronte deri në zemrën e Shqipërisë. Pikërisht këtë rrugë ndoqi apostulli Pal. Gjatë udhëtimit të tij të tretë, rreth vitit 59 pas Kr., ai i shkruante bashkësisë së krishterë të Romës se "që nga Jeruzalemi e përfaqë në Ilirik u kam predikuar të gjithëve ungjillin e Krishtit." Parafjala greke "në" (Ilirik) është e dykuptimtë, pasi nënkupton një përdorim përjashtues ose përfshirës. Pali nuk u shpreh qartë nëse ai e kishte çuar ungjillin e krishterë deri në kufirin ilir apo nëse ishte futur me të edhe në provincë.

Edi Shkriu shkruan: Krishterimi në Dardani nisi të përhapet herët dhe u bë fe zyrtare nga shekulli IV si dhe në gjithë perandorinë romake. Dardania në përgjithësi u bë edhe udhëkryq i përplasjes së doktrinave kishtarë, të asaj lindore dhe perëndimore, nga të cilat pas shekullit XI u krijua trashëgimia kulturore katolike dhe ortodokse e banorëve të Kosovës. Gjurmët e kishave të shumta dhe toponimet, si janë Lisi i popit apo Lisi i priftit, i dëshmojnë këto ndarje dhe, mes tjerash, edhe manifestimi i Shën Gjergjit sipas kalendarit katolik apo ortodoks, ky i fundit i manifestuar edhe nga banorët shqiptarë të besimit islam.

7.

Ulpiana i është dhënë statusi kombëtar arkeologjik faqe në vitin 1955, nën Rezolutën nr. vEK21/55, i cili siguron një nivel të kategorisë së Mbrojtjes. Të dhëna të tjera për Ulpianën janë: Ulpiana / Iustiniana Secunda zë një pozicion të imponuar brenda piktoresk rrethinat e maleve të ulëta për Lindjen e (zona minerare) dhe të mrekullueshme horizonti drejt fushave Kosovës. Kërkimorë arkeologjike, si dhe zbulimi i një amfiteatër dhe ndërtesa të tjera të rëndësishme, i jep një potencial të madh për të përdorur për arsimin e trashëgimisë dhe respektit të ndërsjellë të njerëzve lokale, veprimtaritë kulturore, rekreative dhe ekonomia turistike të zhvillimit.

Kompleksi arkeologjik Ulpiana është i përbërë nga: 1) Nekropoli, 2) kështjella / Castrum 3) Qyteti, 4) Nekropoli Veriore, 5) Nekropoli Perëndimore, 6) Nekropoli Jugore, 7) Tuma Arat e Cerkezit (Čerkesko Polje) dhe 8) Tuma Cernica. Shkalla e arkeologjike (më shumë se 35 ha) është vetëm pjesërisht, gërmohet ne 2% te tij. Gërmimet arkeologjike filloi në 1954 dhe periodikisht vazhdoi deri në vitin 1997.

Përgatite nga Gëzim Llojdia, Mrs. Anëtar i Akademisë Evropiane të Arteve Autori ka qene Drejtor i parqeve arkeologjike te Vlorës

Marre nga "Tribuna Shqiptare", 9 shtator 2014

Gripi



nga Mjek Ndue NIKAJ

Gripi ose influenza është një sëmundje infektive dhe shpesh të kantagioze ngjitese e shkaktuar nga njëri prej tre viruseve me ARN (Acid ribo-nucleinik) të familjes orto-mixo-viridae; mixovirus influenzae A, B, C që prek zogjt dhe disa mamifer midis të cilve derra, fokat dhe qëniet njerzore.

Gripi ose influenza ku shprehet "Influenzae di freddo" që në vitin 1733, ku jepet ndikimi nga të ftohtit dhe stina e dimrit, pra ndikimi i ambientit ndaj njeriut, ku virusi ka aftësi të jetojë mirë jashtë organizmit në kohë të thatë e të ftohtë, arsyeja pse epidemia zhvillohet në dimër me kohë të qetë

Po ashtu fjala gripe, vjen në frengjisht nga fjala gjermane "grippen" ose agrippen që do të thotë mberthe (kap) shpejt.

Në simpoziumin e Beltsville – Mariland në 1981 është vendosur më shumë të flitet për "peste të pulave", për "influenzae shumë patogjene", në kohën që patogeniteti nuk varet vetëm nga virusi, por edhe nga imuniteti i fituar nga individ.

Viruset-shtamet përgjegjëse për gripin janë viruse me ARN siç u shpreh më lart të familje orto-mixoviride dhe gjini influenze virus me tre forma A, B, C i diferencuar nga antigenet e Nukleo-proteinave tyre. Midis viruseve të gripit: "A" janë më të shpeshtit dhe më virulentët, si në 2003; me nën tipa në bazë të antigenit sipërfaqësor si hemaglutina H-2 e H-17- antigenet 1 e 17 të identifikuar më vonë dhe neuraminidaza N-1 e N-9. Viruset "A" dhe "B" janë përgjegjëse të epidemive gripale vjetore por vetëm viruset "A" janë në origjinën e Pandemive gripale. Virusi "C" duket se lidhet me raste sporadike, që japin grip të moderuar, viruset A e C infektojnë shumë specie, ndërkohë që virusi B, është specifik për njeriun (është takuar vetëm tek fokat).

Klasifikimi i viruseve gripal nuk aplikohet vetëm për virusin "A" ku ka disa nëntipa me virulencë të lartë për njeriun (supra-pathogen). Klasifikimi bëhet duke u mbështetur në vetit antigjenike të hemiaglutinazës (H) dhe të Neuraminidazës (N). Ekzistojnë 16 nën tipa "H"; dhe janë 9 nën tipa "N"; pra mund të kemi 16x9= 144 kombinime të ndryshme. Tek njeriu ekzistojnë viruset me nën tip H-1, H-2, H-3 dhe N-1 dhe N-2 përgjegjës për gripin stinor vjetor. Vitet e fundit një virus me patogenitet të lartë me Hematoglutinin (H-5) dhe neraminidaze (N-1) përhapet në formë të një Pan-zoocisë të influenzës haviare (epidemi botrore në zogj), që transmetohet shumë rrallë në njerëz. Në këtë rast është fjala për grip haviar (shpendsh), që aktualisht ka nëntipa të virusit haviar me mundësi patogjene shumë të ndryshme si p.sh: A-Children-shanton-423, 2003 (H5-N-1) ose A/barheaded, G ose (Qinghai/5/2005 (H-5-N-1); pra lloji i kafshës ku është izoluar shtami viral me numër shtami, viti i izolimit (nëntipi), janë izoluar, nëntipa me mundësi patogjene për njeriun në mamifer si kuaj e derra etj; H-5 e H-7.

Mutacionet (transformimet) e variacioneve antigenike të virusit kanë një imunitet të përkohshëm.

Në 2005 OMS (Organizata botërore e Shëndetësisë) ka kërkuar zëvendësimin e nëntipit të Influenza A/Fujian/411; 2003 (H-3-N-2) me serotipin A/California 7/2004 (H-3-N-2) për pregtatjen e vaksinës antigripale.

Gripi më shpesh prek në stinën e dimrit, fenomen i cili nuk njihet mirë, për të cilën ka shumë shpjegime si më poshtë:

Paksimi i nivelit të rezeve ultra-violet (UV) të diellit që bën që virusi të jetojë me gjatë në ambient.

Në periudhën e ftohtë mbetemi më tepër brenda shtëpis.

Sinergjia e mundshme me infeksionet e ndryshme favorizohet në dimër:

Temperatura e ftohtë (5° C) favorizon transmetimin e virusit, i cili ulet në 20° C dhe ndërpritet (zerohet) në 30° C.

Lagështia në ajër 20-35% favorizon po ashtu infektimin e ajrit, pra në një ajër të thatë dhe të ftohtë virusi është më i qëndrueshëm dhe më i fortë për infexion.

Mutacionet (transformimet) gjenetike është në origjinën e pandemive të mëdha botrore të gripit në shekullin e XX si në 1918 "Gripi Spanjoll", në 1957 "Gripi aziatik", në 1968 "Gripi Hong-Kong", këto epidemi botrore (pandemi) janë karakterizuar me sëmundshmëri dhe

vdekshmëri të lartë. Ku gripi spanjoll në 1918-1919 shkaktoi nga 30-100 milion viktima në botë (Sipas vlersimit të insitutit Pasteur ishte 40 milion. Virusi shkaktar i asaj kohe ishte i afërt me gripin e derrave dhe shumë i ndryshëm nga ky i epokës tonë. Nga ana klinike - : periudha e fshehtë (inkubacionit) e shkurtër (1-2 ditë) sëmundja fillon në mënyrë brutale (të menjëshme) me një ethe 38,5 grade Celcius, me të dridhura (frisone) dhimbje koke, ndjenjë e gjendjes së keqe dhimbje në kyçe (artralgi), kësaj tabloje (këtëj kuadri) i shtohen shenjat nga ana e aparatit të frymëmarrjes, me prekje të mushkrive, rrjedhje nga hundët të bollshme dhe ujore, vështirësi në gëlltitje dhe ngjirje zëri. (dysfoni);

Ethja pas 2-4 ditve kalon



shpejt, mbetet lodhje dhe kolla përsiston deri në 2 javë. Duhet të ndiqet observimi i situatës gripale. Pas periudhës së fshehtë ka një ethe të lartë 39-40 gradë celcius, pastaj një rënie dhe ringritje në formë "V", po ashtu tendencë për të vjellur dhe të vjella, sidomos në fëmijë, ku shpesh ka dhe gastro-enterit, që simulon helmimet. Ka rrezik për ndërlikime ku duhet të llogariten sidomos tek të moshuarit, të porsalindurit dhe fëmijët nën 5 vjeç, gratë shtatzëna ose ato me sëmundje shoqëruar si : imunodepresion – rënie të forcave mbrojtëse – diabetikët, të sëmurët me zemër, me bronkopneopathi; të sëmurë me veshka etj. Gripi shpesh është një faktor që rëndon gjendjen e të sëmurve me veshka etj. Gripi shpesh është një faktor që rëndon gjendjen e të sëmurve duke prishur ekuilibret, pra e rigjallëron patologjinë e stabilizuar. Megjithatë format e komplikuar janë të rralla ato janë tepër të rënda, me edeme acute të mushkrive me manifestim të deficitit kardiak, me myokardit, duke iu mbivendosur një infexion bakterial që e kompromenton gjendjen duke dhene rabdomiolizë (shkatrim të muskullit të zemrës) duke prekur trurin pra forma neurologjike, mening

git limfocitar. Kështu forma me mbivendosje të infexionit bakterjal nga ulja e forcave mbrojtëse të organizmit si: bronkiete, bronkopneumoni, pneumoni lobare bakterjale sekondare, sinusite në fëmijë, po ashtu mund të takohet dehidratim (exikoze) nga humbja e lengjeve me të vjella, bark, nga temperatura dhe mos marrja e lengjeve; mund të rrëzikohet i sëmuri për tromboemboli nga qëndrimi shtrir dhe hemokoncentrimi prej humbjes së lengjeve. Shfaqja e një gripi malign (supratoxik) mund të shoqërohet me dystres respirator të rëndë; i ashtë quajtur SARS (Syndromi Acut Respirator i rëndë severe), mund të çfaqet Syndromi Reye në rastin e marrjes së Aspirinës sidomos në fëmijët nën 8 vjeç, prandaj nuk duhet të përdoret si antipyretik për të ulur temperaturën ASPIRINA në fëmijët gjatë gripit. Në rastet e gripit të rëndë nuk duhet kurrë të harrohet mundësia e evoluimit drejt vdekjes, duhet të dihet se gripi është shkaku i tretë ose i dytë i vdekshmërisë nga sëmundjet infektive (kështu në Francë ka 2000-4000 vdekje çdo vit pas pneumonis pneumokoksike.

Një tablo; e tillë e gripit ka shenja specifike me insuficencë respiratore dhe herë herë me falimentë shumë organeve të brendshme, një infexion i tillë ndjek gjithnjë personat fraxhil (të brishtë).

Përsa i takon parandalimit/higjiena e mirë është masa e parë parandaluese e kontagiozitetit (e ngjitjes) në periudhën epidemike; të lahen duart shumë herë me ujë e sapun dhe të dezinfektohen me Alcool; kloraminë etj, të shmangim kontaktet fizike me personat e infektuar. Të mos pështyhet për tokë, të mos hedhen kudo letrat higjienike, por të hidhen në koshat e plehrave, mos fërkoni sytë me bulat e gishtave, por me nejet e gishtave (çdo përon fërkon sytë nga 20-50 herë në ditë), para testitjes vendosni shami përpara hundëve ose shpindën e dorës.

Mund të përdorni maska parandaluese para hundëve, sidomos personeli shëndetësor;

Të sëmurët me gripp të izolohen nga të shëndoshtit në çdo rast, mos bini në kontakt të pa nevojshëm, ajrosni dhomen e të sëmurve, të dezinfektohet çdo objekt që përdor e kontakton i sëmuri me grip.

Po të gjeni një zog të ngordhur në tokë mos e prekni.

Por sidoqoftë vetem masat higjienike e dietike nuk e zgjidhin çështjen. Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë që ka një nivel deri në 60%-90% për gripin stinor. Ulen sidomos format e renda dhe shtrimet në spital po ashtu dhe vdekshmëria

nga gripi.

Në shumë vende të industrializuara vaksinimi behet falas në grupet shoqërore me rezik për ndërlikime si: të moshuarit mbi 65 vjeç, të sëmurët me sëmundje kronike si Diabetikët, të sëmurët me zemër, me ulje të imunitetit, të sëmurët me veshka, me BPCO (pneumopat kronik), asthma. Përsonat që punojnë në vende kyçe të shërbimit si, aviacioni, PTT, spitale etj.

Tek ne kanë hyrë vaksina nga firma të ndryshme, dhe nuk rimbursohet për asnjë shtresë të popullsisë, por kjo vaksinë freskohet për çdo vit, sipas llojeve të viruseve që atakojnë në dimrin parardhës, ku përmbahen dy nëntipa të gripit "A" dhe një nëntip i gripit "B" dhe imunizimi krijohet 2 javë pas vaksinimit, por mund të bëhet dhe një dozë e dytë pas një muaji. Në rastet kur përoni është infektuar mund të përdoret antiviral si: OSELTAMIVIR "R" dhe të mbron deri në 80% po u përdor brenda 48 orve të para të infektimit, sidomos në personat mbi 13 vjeç.

Trajtimi. Ngritja e temperaturës qendrore (ethe) është një mekanizëm fiziologjik imunitar që përfshin biokimin e replikimit viral. Nuk ka prova shkencore të përfitimit (në termin e sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë) të trajtimit simptomatik të infexionit viral acut stinor dhe të infexionit gripal në veçanti. Qetsia disa ditë me ndalim të punës për të ndaluar përhapjen e infexionit është e domosdoshëm.

Trajtimi me ilaçe mund të përfshijë antalgjik (kundër dhimbjes), kundër kolles, antipyretik (paracetamol, brufen, ponstan etj), po ashtu vitaminë C kundër lodhjes së shkaktuar nga syndromi gripal. Aspirina kundër-ndikohet në syndromin gripal pasi mund të zhvillojë syndromi Reye, i cili është i rrallë por me potencë mortale. Luftimi me dehidratimin (exikozën) është i nevojshëm në funksion, të ethes dhe djersitjes e të vjellave. Ka ilaçe anti viral sidomos kundër gripit "A" Amantadina e Ramanadina që kanë një efikasitet 80% i përdorur për profilaksi dhe OSELTAMIVIR "R" (TAMIFLU) dhe ZANAMIVIR (Relenza) "R" janë frenues të NEURAMINIDAZES, ilaçe të cilat të marura heret mund të ulin rëndësinë e simptomave dhe afatin e afexionit dhe kanë aftësi të parandalojnë atë në një masë të madhe, por janë me kosto të lartë dhe duhen përdorur 48 orë para se të çfaqen shenjat. Antibiotikët janë vetëm kundër baktereve dhe duhet të rezervohen në rastin e mbivendosjes së infexionit bakterjal dhe të jepet fillimisht klasa më e thjeshtë si: AUGMENTINA. Por mos merrni asnjëherë inisiativë të vetmjekoheni, por merrni këshillën e mjekut tuaj.

MENDIME RRETH DIËA QËNDRIEMEVE NDAJ LUFTËS NAÇL

Nuk desha të shkruaj për Shtatëdhjetë vjetorin e Çlirimit të Atdheut, sepse kam shkruar edhe here të tjera për çlirimin e atdheut dhe kam dhenë mendimet e mia, por disa komente kohet e fundit jo vetëm që më shqetësojnë, sepse jo pak njerëz shprehin mbi bazen e emocioneve dhe jo pak njerëzve ju mungon arsyeja, ose janë te dyja bashke, që nxjerrin jo pak mendime të paqëndrueshme ndaj historisë, ndaj kohës dhe jo në shërbimin të së ardhmes. Prandaj me detyruan ti futem kësaj pune, jo se do të ve piken mbi "i", por mendoj se do të sqaroj disa koncepte.

Së pari, është shumë interesant debati nëse kishte Luftë Nacional-Çlirimtare apo jo në Shqipëri?! Me duket një debat pa buke, që nuk të çon asgjëkund, veçse po turpërohemi para historisë dhe brezave të ardhshëm, të cilët do na kërkojnë llogari. Ata do të jene më me pak emocione, që do të jene më gjakftohte, arsyen do ta kenë më të shëndoshtë, do të jene më me pak komplekse dhe "kërraba" do t'iu tërheq më pak nga vetja.

Në fund të Luftës Nacional-Çlirimtare, Ushtria Nacional-Çlirimtare doli nga lufta me një efektive mbi 70 000 forca luftarake të rreshtuar në 24 Brigada Sulmuese, të grupuara në 8 Divizione Sulmuese, në 3 Korparmata dhe 2 Qarqe, me të cilat u bë e mundur çlirimi i vendit me datën 29 nëntor 1944, duke përballuar rreth 15 Divizione italiane dhe gjermane, dhe nxjerre jashtë luftimi rreth 70 mijë armiq, të vrare, të plagosur dhe robër. A mund te thuhet se nuk është bere Luftë Nacional-Çlirimtare?! Kurrsesi jo.

Së dyti, është shumë interesant debati nëse në Shqipëri kishte Luftë Civile apo jo?! Në Shqipëri nuk kishte luftë civile, sepse njëra pale, njëra force ushtarake i shërbente pushtuesit. Edhe në ato raste që ndodhen përballë dy forca të armatosura të përberë krejtësisht nga shqiptar, një pale i shërbente dhe mbështetej nga forca e armatosura e pushtuesit. Kështu ndodhi dhe me 5 heroit e Vigut. Ata vërtetë u vranë nga shqiptaret e rajonit të Vigut apo të ardhur nga thellësia e tij, por ata ishin në shërbim të gjermaneve. Pra, në një vend që është i pushtuar nuk ka luftë civile. Luftë civile, ka brenda një vendi që pala kryengritëse i kundërvihet pushtetit në fuqin e armeve, për të përmbys sistemin qeverisës apo për të marrë pushtetin ekzistues. Pra, një luftë nder-veti, një luftë nder etnike brenda një vendi të caktuar.

Për luftën civile shprehet, James Fearon, një profesionist për luftërat civile në Universitetin e Stanfordit, është: "... një konflikt violent brenda vendit, në të cilin luftojnë grupe të organizuara me synimin që të marrin pushtetin në qendër apo rajon, apo të ndryshojnë politikat aktuale qeveritare". Profesori tjetër, Ann Hironaka, thekson: "... njëra anë e luftës civile është shteti..."

Asnjë nga argumentet e atyre që mendojnë ndryshe, nuk i afrohet asnjë përcaktimi për luftën civile. Luftëra civile kanë qenë në Somalia, Burma (Myanmar),

Uganda dhe Angola, Sudan, Kamboxhia, Siri e të tjera rajone apo nacilanlitete. Në asnjë nga këto vende nuk kishte pushtues siç ndodhi në luftën nacionalçlirimtare në Shqipëri. Pra në Shqipëri, lufta nuk lindi për të marrë pushtetin dhe as partitë e krijuara nuk kishin si përparësi marrjen e pushtetit, por kishin përparësi çlirimin e vendit. Këtë, partitë dhe organizmat e krijuara në Shqipëri e realizuan me formimin e Frontit Demokratik, i cili e çliroi Shqipërinë, madje çliroi dhe territore jashtë vendit, nën kryesimin e PKSH, me ne krye Enver Hoxhën, duam apo nuk duam, qofte të ketë qene i mire apo qofte të ketë qene i keq.

Argumenti luftë civile është një shpikje djallëzore për të justifikuar kolaboracioniste, që pinjollat e tyre e bejne për të riabilituar ata dhe ata riabilitohen vetem duke mohuar luftën nacional-çlirimtare dhe duke e cilesuar ate luftë civile. Ky është një turp i vërtetë për ata që e dëgjojnë.

Së treti, është shumë interesant debati nëse Enver Hoxha ishte apo jo drejtuesi i Luftës Nacional-Çlirimtare?! Unë, nuk ndalem se si erdhi në krye të PKSH-Enver Hoxha. Ai u vu në krye të kësaj partie, në krye të kësaj lufte, në krye të këtij fronti, në krye të kësaj force të armatosur dhe çliroi vendin nga pushtuesi nazifashist. Ai u njoh ndernacionalisht, se pranë tij shkuan misionaret e ndërluftuesve kundër Nazizmit e Fashizmit, të Kolacionit Nazi-fashist. Çdo koment tjetër, është humbje kohe ...

Madje ka dhe mendime të tilla se, Enver Hoxha gjate luftës nuk ka zbraz një pushke, në veçanti ky mendim na vjen nga Liri Belishova apo edhe gjenerali i famshëm Rrahman Perllaku. Mire se Liri Belishova nuk e ka pas dhe as nuk e ka të qarte se ç'fare është drejtimi i luftës, por ky gjenerali që ka bere dy akademi dhe ka qene deri Z/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe Z/Ministër i Mbrojtjes, nuk e ka të qarte se ç'fare është drejtimi në lufte?! Ai ishte në fillim Komisari dhe më vonë Komandanti i Përgjithshëm dhe si i tille nuk do të dilte në vije të pare për të luftuar në rol të partizanit të thjeshtë. Pra, marrja me të këtila cingërima atij nuk i ulin dhe as i ngrijnë më larte vlerat se ç'i ka pas, por dëmtojnë reputacionin e vetvetes.

Së katërti, është shumë interesant nëse PKSH u krijua brenda vetes apo e krijuan nga misionaret jugosllav!? Edhe debati për këtë çështje është humbje kohe. Në çdo vend të vogël janë influencat e më të mëdhenjve. Fqinje me ne, që udhëhiqej nga Kominterni ishte edhe Jugosllavia, forcat progresiste partizane që udhëhiqej nga PKJ, me në krye Titon. Edhe te ne ishin sjell direktivat e Kominternit nga vete shqiptaret. Edhe te ne ishin krijuar grupet komuniste, si i Shkodres, i Korces, i Zjarrit e të tjerë. Pra, ideja ishte brenda vetes. Brumi ishte i joni dhe u gatua nga ne, pavarësisht ndihmësës te të huajve, që në këtë rast ishin të deleguarit e PKJ. Nuk ndodhi si me të famshmin-Mbretin

Ahmet Zogu, që erdhi në pushtet me forcën e armeve të Pashqit duke i bere lëshime dhe duke i dhenë dhurata nga hapësirat shqiptare ... Asnjë force e armatosur jugosllave nuk i la eshtrat gjate kësaj lufte në token shqiptare.

Se pesti, nëse kane luftuar ballistet e legalistet apo jo?! Unë nuk humb kohen me përcaktimin e kësaj çështje. Koha që do të vij do ta shkruaj saktësisht ... Por, di me siguri që nga Balli e Legaliteti formacioni luftarak me i larte ishte një batalion dhe u patën formuar disa çeta balliste e legaliste. Nuk pat asnjë njësi ushtarake, nuk pat asnjë udhëheqje ushtarake, nuk pat asnjë strukture për përgatitjen ushtarake dhe edukimin e efektivit të kësaj force që udhëhiqej nga këto dy forca politike, që mendonin të çlironin vendin në bashkëpunim me pushtuesin dhe të merrnin pushtetin. Madje vijon edhe sot me force të propagandohet se Kosovën e shiti PKSH, i cila asnjëherë nuk ishte pjese administrative me Shqipërinë, perverse në kohen e Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste, të cilët për të pas këtë popull pjese të tij, për ta pas mish për top, siç ndodhi me Rumaninë, Bullgarinë e ndonjë tjetër vend, nxori termin Shqipëria Etnike, e cila na kushtoi shume, kur ishte e qarte se rreshtimin në koalicionin antifashist botëror, pas lufte nuk do të ndryshonin kufijtë, sepse atëherë do t'iu kushtonte shume kohe dhe probleme ndoshta që do mund të çonin edhe në luftëra civile, siç ndodhi ne Greqi ...

Po, këto kohet e fundit na dalin heroin edhe disa figura të çuditshme, si Muharrem Bajraktari e ndonjë tjetër. Këta zotërinj a e dine se kush ka qene Muharrem Bajraktari? A e dine, se me forcën e bandave civile të këtij "heroi" dhe të Preg Previzit jo vetëm që në vitin 1926-1927-Ahmet Zogu shtypi kryengritjen e Dukagjinit kundër tij, por u bën persekutimet e jashtëzakonshme në Dukagjin dhe në klerin katolik të kësaj zone?! Ju them, zotërinj lexoni ardhjen e Ahmet Zogut në pushtet, të shkruar nga paderë Kamilio Libardi, famullitari i Shoshit në ato vite ... Ky, Muharrem Bajraktari jo vetëm që na del i persekutuar e dekorohet nga Sali Berisha, por me sa di,do i ngrihet një statujë e madhe në qendër të qytetit të Kukësit ... Hajde demokraci hajde ...! Hajde vleersim historie hajde ...!

Së gjashti, është mjaft interesante ideja e hedhur: "Pushtimi komunist ...". Në këte kohe, shume ide janë hedhur: Pushtimi sllavo-komunist! Pushtimi islamo-komunist! Madje edhe është hedhur e ideja se: Jugu pushtoi Veriun e Shqipërisë!? Në vitin 2004, mund të ketë qene muaji maj, në hotel-turizmi "ROZAF", behet një paraqitje e vëllimit me poezi "Gjurmët" të autorit Zef Mirakaj, me banim në SHBA dhe parathënien e këtij vëllimi e kishte përgatitë një me grade shkencore Profesor Doktor, i cili në mes të tjerave shkruante: "... bini toske e duroni geqe ...". Ai, duke preferuar thënien e Fishtës: "Bini Toske e bini Geqe", fut jo

vetëm ndarje krahinore në mes Jugut të Shqipërisë dhe Veriut të Shqipërisë, por fut konflikt të armatosur në mes tyre, siç deshi të fuste në konflikt të armatosur Sali Berisha-në pozicionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në fillimet e Pranverës së vitit 1997 dhe ta kthente vendin në lufte civile. Ketë po ta thoshte një amator nuk do të behej objekt i këtij shkrimi, por ta theksoi një me grade shkencore (profesor doktor) është një turp çka do të thotë vetëm injorance me shkolle dhe grade shkencore, asgjë me shume. Megjithate, mund ta zbus velresimin e këtij profesori, sepse ai nuk ben nga mosdija, por e ben te qëllimshme per t'i shërbyer dikujt ... Jo pak ka të tille, që janë fatkeqësia e këtij vendi. Prandaj këto theksime mbesin me kaq, por më vjen keq se me këta profesor brezat që do vine, do të qeshin ...

Së shtati, ishte interesant "zbulimi" i Vendkomandës së Përgjithshëm në afërsi të Babrrus, gjoja ishte strehimi i Enver Hoxhës me suitën e tij, për t'i shpëtuar kokën atyre nga një goditjeje bërthamore ... Është vërtetë për të qeshur, është për ndonjë estrade ... Këta "zbulues të famshëm" a kane njohuri sado pak për përgatitjen e vendit për lufte? Këta e quanin paranojake të mendjeve të kohës së shkuar këtë ndërtim, që e zbuluan këta "zbulues" të "demokracisë".

Ky njoftim ishte jo real. Objekti ka qene për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. Byroja Politike dhe Qeveria e asaj kohe kishin shume objekti drejtimi, njeri ishte në Kërrabë dhe tjetri në mal të Dajtit, te antenat. Duhet të dimë kohen kur vendi kaloi në fortifikimin e përgjithshëm të tij, duke zbatuar elementin e trete të luftimit, atë të përgatitjes së terrenit në pikëpamje xheniere, në fortifikimin e tij. Pse? Në kohen e Luftës së Ftohte e gjithë bota përgatitej për lufte, në veçanti dy kampeve më të fuqishme të makinës ushtarake, në mes Traktatit të Varshaves dhe NATO-s, duke mos llogaritur më gjate për mirëqenien e popullit. Të gjitha vendet e Evropës fortifikoheshin, megjithëse kishin armen atomike. Edhe Suedia, Zvicra, Austria e të tjera vende. Po ne ç'fare do të bënim në ketë situatë, në veçanti në kohen që ne denoncuam Traktatin e Varshaves dhe duke dale prej saj në mënyrë demonstrative, nga një traktat jo për paqe, jo për mbrojtje, por nga një traktat agresor?! Pa tjetër do mendohej për mbrojtjen e vendit. Ai i kushtoi shtrenjte vendit e popullit fortifikimi? Pa tjetër i kushtoi shtrenjtë, por nuk kishim mundësi tjetër për të përballuar agresionin e mundshëm. Nuk mund të prodhohim armen atomike. Nuk mund të prodhohim arme të renda, perveçse armë të lehta të këmbësorisë. Atëherë për arme të renda deri dhe aviacioni e anijet luftarake duheshin përgatitë terreni për ti siguruar ashtu siç u siguruan.

Nuk kam ndërmend të flas për fortifikimin dhe ti bej analize atij, por e bëra këtë hyrje se na diktoi koha dhe koncepti

i Luftës Popullore, Populli Ushtarë. Vend strehim apo vend drejtim nuk kishte vetëm udhëheqja ushtarake apo politike, por i gjithë populli. Skuadra përveç pese apo me shume qendrave të zjarrit që kishte, njëra prej tyre ishte me strehim kolektiv në baze skuadre. Komandanti i togës apo i kompanisë po të njejtën gjë, kishte vend-drejtimin e tij, në skuadrën e trete apo në togën e trete. Komandanti i batalionit kishte vendkomandën (PD) në thellësinë e rajonit të mbrojtjes së batalionit. Komanda e shtabi i brigadës kishte vendkomandën dhe vend-drejtimin, me rreth 17 dhoma. Komanda e Korpusit apo Divizionit kishte vendkomandën dhe vend-drejtimin operativ me mbi 32 dhoma. Po kështu kishte vend-drejtimin Shtabi i Mbrojtjes së Rrethit. Në qytete, në baze ndërmarrje ishin llogarite personale që do të vijonte prodhimin qofte për popullatën, qofte për lufte dhe për çdo lagje apo bllok ishin strehimet për popullatën. Në zonat aktive të luftës, popullata e paafte për lufte, ishte llogarite të largohesh nga kjo zone dhe të dërgohesh në thellësi të rrethit. Për ta ishte plani i plote, ishin caktuar forca shoqëruese, automjetet e transportit, rruga e lëvizjes dhe vendi ku do të vendoseshin, mënyra e trajtimit të tyre, e të tjerë e të tjera. Çdo arme artilerie kishte pozicionet e zjarrit të saj, qofte në vije të pare, qofte në thellësi të rajonit, të brezit apo të zonës, në të cilat jo vetëm ato arme mbroheshin dhe nga ku behej qitje, por strehohesh dhe efektivit i tyre. Pra, dua te theksoj se udhëheqja e asaj kohe nuk ishte paranojake, por ishte e përgjegjshme për vendin e për popullin për ta siguruar në kohe lufte. Nuk e di se si mund të flitet sot, po të ishte bere lufte!?! lutemi ZOTIT dhe e falënderojmë që nuk u bë lufte.

Ju tregoj një episod të vogël: "Në vitin 1991, pas vendosjes së pushtetit pluralist, ishte një situatë gatishmërie e larte se rrezikoheshim nga fqinjët. Pas një mbledhje në Komandën e Divizionit në Shkodër, caktohem me Kryetarin e Komitetit Pluralist të rrethit Shkodër, i cili ishte dhe në detyrën e Kryetarit të Shtabit të Mbrojtjes së rrethit Shkodër, të bëjmë inspektim në efektivat e gatshme dhe në postave kufitare. Shkuam në çdo qendër zjarri të rajonit të mbrojtjes së postave kufitare, për të pare se si mirëmbaheshin ato dhe sa ishin të gatshme efektivat për të luftuar nga ato ... Në kthim me pyet kryetari: N/Kolonel a mundemi t'i bëjmë balle një agresioni të mundshëm prej fqinjëve? I përgjigjem: Zoti Kryetar arme dhe municion kemi mjaft, fortifikimin e kemi të plote, siç pate vete, por në ketë situatë të krijuar politike nuk e di se si janë zemrat? Dhe kjo më shqetëson! Kryetari nuk foli më, hipëm makinës dhe erdhëm në Shkodër" ... Mos ardhte ajo dite, se nuk mund ta imagjinoje qëndrimin e këtyre pseudopatriot, që përrallisnin sot ...!

Së teti, ishte shume interesant reagimi i ambasadorit te SHBA, me rastin e përkujtimit të datës së Çlirimit të kryeqytetit të Tiranës, i cili, nder të tjera tha: "... Enver Hoxha mostër ... Kjo atmosferë u prish". Pyetja e thjeshte: A i lejohet një diplomati të shprehet në ketë mënyrë për një figure, të cilin e duan shume shqiptar? Mendoj se nuk i lejohet, sepse në demokraci secili ka të drejte dhe nuk i merre kujt leje për idhullin e tij. Ka të drejtën e tij se ku do të besojë, ku do të falet, ke do të duar-

trokas e të tjera e të tjera. Lexoja në vitin 1993, në një nga numrat e gazetës "Kombi", që në Londër në një date të caktuar dy turma ecnin në të njëjtën rrugë, por pas pak u ndanë. Njëra turme shkante drejte një monumenti të larte, i cili ishte i një gjenerali dhe turma tjetër shkante drejt varrezave, në të cilat ishin varret e viktimizeve të këtij gjenerali. Megjithatë, askush nga turmat nuk ju kundërvu njerit-tjetrit! Pse? Sepse, secili kishte të drejtën e tij. Prandaj i nderuar Ambasador mendoj se keni gabuar në ketë rast. Me ketë që deklaruat jo pak politikan për të justifikuar qëndrimin e tyre ju kane marre për reference. Ju dhe ata që iu referuan juve, duhet ta dini se jo vetëm kane të drejtën e tyre, por ata janë të ligjruar, çka do të thotë se ligjërisht nuk keni të drejte ju dhe ata, tu kundërvihen PKS, tu kundërvihen veteraneve, sepse ata mbani portretin e atij që udhëhoqi Luftën Nacional-Çlirimtare në lufte me pushtuesin nazifashist. Ai, Enver Hoxha i mire apo i keq është figure historike e Popullit Shqiptar.

29 Nëntori, për Popullin Shqiptar është një dite e shënuar, është dite e paharruar, dita e 70 vjetorit, kur luftëtarët shqiptar çliruan përfundimisht vendin nga pushtuesit e huaj. Atdheu ynë u çlirua nga vete shqiptaret, pa ndihmën e drejt-përdrejte të anëtarëve të Koalicionit Antifashist Botërorë, që sakrifkuan gjithçka për një Shqipëri të lire dhe demokratike. Ne e kemi mjaft të pasur historinë, me luftëra ndaj pushtuesve. Kemi luftuar me vendosmëri për të siguruar mbijetesën tone si nacionalitet, kemi luftuar për liri, për pavarësi dhe për progres.

Me shpirtin liridashës në shekuj, në lufte për çlirimin e Shqipërisë dhanë kontributin edhe dukagjinast. Me 5 nëntor 1943 u krijua çeta partizane e Dukagjinit, me 36 luftëtarë, në fshatin Peshumaj, me udhëheqës Politik profesor Kole Prela, Komandant Gjon Marashi dhe Komisar Market Pjetra. Ajo u rreshtua në batalionin "Perlat Rexhepi" dhe mori pjese në luftime kundër pushtuesve fashistozist dhe kolaboracionisteve në rajonin Vorf, Rrashkullaj, Mes, Myselim dhe Bardhaj.

Në themelet e çlirimit të Shqipërisë, me gjakun e 28 mijë dëshmorëve është dhe gjaku i 7 luftëtarëve dukagjinast në krye "Heroin e Popullit" Tom Kola, komisar in e kompanisë në Br1S, Vat Luc Lula e të tjerë. Një pjese prej tyre, morën pjese për çlirimin e tokave dhe popullit të Jugosllavisë, si Ndok Marashi prej fshatit Gjuraj dhe Ndue Gjellosh Vata prej fshatit Toplane. Vata, në këto luftime dha jetën ne lule te rinise.

Krijimi e çetës partizane të Dukagjinit, populli e përjetoi në këngë: "Kur mbi ne bisha fashiste / Mbillte vdekje, digjte, vriste / Dukagjinit po i çojnë fjale / Baca Gjon e Baca Bale / Kush don zot me i dale vatanit / T'bien te kulla e Mark Milanit / Besa-bese me u lidh me deke / N' Dukagjin ta bajme një çete ..."

Të gjithë dukagjinast kudo që ata jetojnë, si dhe gjithë popullit shkodrane e atij shqiptar, Ju uroj gëzuar 29 Nëntorin 2014, ditën e 70 vjetorit të Çlirimit të qytetit Shkodër dhe të gjithë Shqipërisë sonë të shtrenjte!

Ndue Sanaj

"Mos u thaftë rrënja e lisit, qoftë me fat Dita e Plisit"

Në fshatin Krushevë të Klinës, në Muzeun e piktorit, poetit dhe krijuesit të njohur z. Gjon Gjergaj, e me nismën e artistit të popullit z. Ismet Krasniqi, u mbajt manifestimi: "DITA E PLISIT"

... të gjithë me plisa të bardhë në kokë e një pjesë e pjesëmarrësve edhe me rroba tradicionale e kishin zbukuruar kul-lën shqiptare të Krushevës së Klinës, të mërkurë e 15 tetorit 2014...

E mërkurë, ditë e mesit të javës, ditë vjeshte, gjysmë me diell e gjysmë me re, në një fshat piktoresk dhe të bukur të Klinës, Krushevë, me nismën dhe nën udhëheqjen e z. Ismet Krasniqi, artist i popullit, poet, shkrimtar dhe krijues i kulturës shqiptare, në Muzeun e z. Gjon Gjergaj, më 15 tetor 2014, u mbajt një manifestim jo i rëndomtë, i quajtur "ITA E PLISIT". Ky manifestim i këtij lloji ishte i pari që mbahet në trojet shqiptare.

Ishin të ftuar përfaqësues nga e tërë Kosova, madje edhe nga Medvegja e Kosovës Lindore. Ishin këtu së bashku poetë, artistë, shkrimtarë, përfaqësues të institucioneve të qeverisjes lokale, qytetarë dhe të reja e të rinj shqiptarë.

Manifestimin e hapi prof. Ismet Krasniqi, i cili me kumtesën e tij, përzemërsisht i përshëndeti të gjithë përfaqësuesit e pranishëm, duke ju uruar qëndrim të këndshëm. Në fjalën e tij ai ceku se gjatë kishte menduar, e shumë herë e kishte biseduar me shokët dhe bashkëpunëtorët e vet për mundësinë e një manifestimi kushtuar Plisit shqiptar, simbolit të veshjes tradicionale, i cili i bëri ballë çdo furtune deri në ditët e sotme, duke qëndruar me krenari në kokën e shqiptarit, në punë, në dasmë dhe në luftë.

Falënderoi të gjithë për kontributin në shënimin e fillimit të kësaj feste duke emëruar atë "DITA E PLISIT", për çka u pajtuan të gjithë të pranishmit, duke sugjeruar që kjo të bëhet festë e përhershme më çdo 15 tetor. Në veçanti falënderoi pronarin e Muzeut, z. Gjon Gjergaj, i cili me kënaqësi kishte hapur dyert e këtij muzeu dhe të shtëpisë së tij për këtë manifestim dhe për pjesëmarrësit e tij. Me pastaj me kumtesën e tij, ai beri një vështrim historik dhe studimor për rrugëtimin e "Plisit" shqiptar.

"Ngjyra e bardhë e plisit është simbol i pastërtisë, dritës e përparimit, kurse "plisi" është simbol i identitetit shqiptar", tha në mes tjerash prof. Prend Buzhala, poet, krijues dhe kritik letrar, me kumtesën e vet dha kontribut të çmuar për këtë manifestim "Plisi" është relik i shenjtë ndaj të cilit shqiptari përkulej dhe e mbante me nderim të thellë", ceku në fjalën e tij përshëndetëse prof. Fadil Hysa, themelues i Etno Festit.

Prof. Rexhep Abazi, poet, shkrimtar dhe publicist, i cili kishte ardhur edhe me dy përfaqësues të Grupit folklorik "Shpëtimi" nga Medvegja (Shefki Halimin dhe Kadri Abazin) në fjalën e tij përshëndetëse, shtoi: "Unë sot këtu erdha nga Medvegja, me njeriun i cili që nga lindja e deri në ditët e sotme, me moshë

afro shtatëdhjetëvjeçare, e mbanë me krenari "Plisin" e bardhë shqiptar, e që në Medvegjë nuk është edhe aq e lehtë - z. Shefki Halimin nga Tupalla e Zenel Hajdinit e Akademik Idriz Ajetit.

Po ceku vetëm diçka karakteristike lidhur me plisin shqiptar tek shqiptarët e Medvegjës, ku rreptësisht për meshkujt ka qenë e ndaluar:

Të mos pihet ujë pa e pas plisin në kokë,

Të mos hahet bukë pa e pas plisin në kokë dhe

Të mos dilet nga dera e shtëpisë, as natën as ditën, as në punë as në dasmë, as në arë e as në mal, pa plisin në kokë.

Këto ishin rregulla, të cilat vlenin për çdo moshë dhe për çdo kohë dhe respektoheshin nga të gjithë", tha prof. Rexhep Abazi, duke uruar që kjo dite, "DITË E PLISIT" të bëhet festë e të gjithë shqiptarëve.

Manifestimin e përshëndetën edhe poetë, krijuese, artistë dhe pjesëmarrës tjerë si: prof. Sejdi Berisha, poet dhe krijues nga Peja, piktori dhe poeti i mirënjohur z. Idriz Berisha nga Klina, poeti Tahir Bezhani nga Gjakova, artisti, poeti dhe pronari i Muzeut z. Gjon Gjergaj nga Krusheva, poeti Shasivar Begu nga Shala e Bajgorës, prof. Rasim Beqaj drejtor i Sh.K.A. "Muharrem dhe Xhevat Qena" nga Romaja e Hasit, poeti Mikel Gojani nga Klina e te tjerë.

Në pjesën e dytë të manifestimit me poezitë e tyre u prezantuan poetët: Sejdi Berisha, Tahir Bezhani, si edhe poetët e Klubit letrar "Vorea Ujko" të Klinës: Jehona Gashi, Gjon Gjergaj, Mikel Gojani e Idriz Berisha.

Nën udhëheqjen artistike të rapsodit, instrumentistit dhe valltarit prof. Rasim Beqaj, me një program modest me këngë dhe valle folklorike të pranishmit i argë-



tuan përfaqësuesit e SH.K.A. "Muharrem e Xhevat Qena" nga Romaja e Hasit.

Pjesëmarrësit e këtij manifestimi e vizituan edhe Ateleun e piktorit Idriz Berisha, në të cilin kishte çka të shihej, sepse ishte i stërbushur me punime të niveli të lartë artistik të këtij artisti te njohur.

Për pjesëmarrësit e manifestimit, në mënyrë vullnetare, pa ndihmën e askujt, organizatorët e manifestimit kishin përgatitur edhe një tervese të pasur me ushqime tradicionale shqiptare (flija, pite, krelana, turshi, ëmbëlsira e shumë pije freskuese).

Qoftë me fat DITA E PLISIT!

Përgatitë nga prof. Rexhep Abazi, Medvegjë, 16 tetor 2014

FIGURA E PREND DOÇIT, ABATIT TË MIRDITËS

NË MONOGRAFINË E DR. LUIGJ MARTINIT

Vlerësimi dhe rivlerësimi i figurave të shqueme të historisë sonë, të cilat, falë kontributeve madhore që dhanë në periudha të ndryshme të zhvillimeve tona historike të luftërave e përpjekjeve për liri, pavarësi e çlirim shoqnor, ka qenë dhe mbetet një detyrë e randësishme e historianeve dhe jo vetëm e tyre. Aq ma emergjent bahet një detyrim si ky, kur ndjehet ende kaq shume nevoja me vu në vendin e vet të vërtetat tona historike të mohueme a të shtremnueme nga historiografia komuniste e pseudohistorianëve tendenciozë e nostalgjike politike të asaj së shkueme, që kane guximin ende sot me mbrojte mendësitë e veprën e tyre spekulante që deformatojnë qëllimisht e në shërbim të ideologjisë komuniste, fakte e figura, fenomene e zhvillime të historisë sonë dhimbjeshumë. Si e tillë kjo detyrë merr vlera dimensionesh nacionale e meriton mirënjohjen e shqiptareve. Në këtë kuadër duhen përgëzue shume pena dinjitoze e të perkushtueme historianësh, që realizohen në këto vite vepra të vlerata historike e monografike, tue shenue keshtu konsolidimin e një stadi energjik angazhimesh serioze në këtë krijimtari me vlera të shenueme shkencore, historike e patriotike. Përmes këtyne veprave, rishikimit të historisë, kësaj detyrë, sa shkencore, aq edhe të përgjegjshme, fisnike e qytetare, i vihen në dispozicion një pasuni e tanë fondesh me vlere, tue respektue kështu edhe atë parim te randësishëm filozofik se pohimi bahet kryesisht përmes pohimit e jo mohimit. Pohimi përmes botimesh serioze shkencore-historike e monografike për figura e fenomene, për luftëra e zhvillime politike, mbështete mbi prova dokumentare, fakte e faktologji, ka me shkruie ma në fund historinë e vërtetë shqiptare. Ndjen kënaqësi të veçante intelektuale kur, në këtë sferë angazhimesh, njihesh edhe me veprën e re monografike të dr. Luigj Martinin për një prej figurave madhore te historisë sonë, Prend Doçin, Abatin e Mirditës, i cili, me kontributet e një jete të tanë në shërbim të Atdheut, dominoi skenën historike të zonës së Mirditës e jo vetëm të saj, në atë gjysë të dyte të shekullit të 19-te e të fillim shekullit të 20-te.

Vepra "Abati i Mirditës, Prend Doçi" e dr. Luigj Martinin, mbart vlera të konsiderueshme njohëse historike, frut i një pune të gjate rrënuese e hulumtuese shumëvjeçare, çka domosdoshmërisht ia diktonte autorit jeta e veprimtaria komplekse dhe e gjithanshme e Doçit, shtri ajo gjanësisht në zona të ndryshme të vendit e në atë të tre kontinenteve. Jeta e Abat Doçit, me kompleksitetin e saj të rralle e të veçante, ishte jeta e një veprimtari të perkushtueme në realizim konsekuent qëllimesh të shenjta atdhetare. Ajo e detyroi atë me rrugëtue si misionar e fesë e Atdheut, tue u përshkue në shtigje nga ma të komplikueme jete, të vështira e të ngarkueme me rrezikshmëni të naltë.

Personaliteti i Doçit, performoi orientim të qarte e nuhatje të thelle në sfera të politikës e diplomacisë me sens të theksuem patriotik, tregoi aftësi të rralla imponuese në kuvende vendimmarrëse malësore, aftësi të spikatuna në marrëdhënie, marrëveshje e aleanca me fuqi të mëdha politike e ushtarake të Evropës së kohës e në sigurimin e mbështetjes së tyre në udhëheqje kryengritjesh të armatosura. Të gjitha këto në konjunkturën e nderlikueme të zhvillimeve të mrendshme e të jashtme historiko-politike e ushtarake të kohës. Si e tillë, figura e Doçit ishte e vështirë për t'u "vizatue" e pasqyruie në një vepër monografike, vështirësi kjo deri në rrisqe dështimi, çka ka frikësue gjithmonë autore e historian që kane lakmue me iu afrue asaj. Përmes punës kambëngulose, serioze e ekzigjente autori ia ka dalë me sistemue e me na dhanë një informacion historik të gjane përmasash shterruese. Gjithçka në të mire të dimensionimit të plotë të figurës e personalitetit të Doçit klerik, patriot, mendimtar e veprimtar i kishës e nacionalitetit shqiptar. Uroj që vepra të shkoje tek lexuesi i gjane e sidomos të mbesë ajo në fondet e vlerata të bibliotekave të institucioneve dhe në referencat e studiuësve, për vlerat që ajo mbart, për kontributet e të vërtetave që ajo afro.

Monografia për Abat Doçin ka në qendër të pasqyrimin periudhën historike të viteve të jetës së Abatit, 1846-1917. Natyrshëm në qendër të veprës mbetet figura madhore e këtij kleriku të shquem në jerarkinë kishtare të kohës, jeta e angazhueme prej veprimtari e të cilit, tue u inkuadrue aq përfaqësueshëm si shembull frymëzues i idealeve të binomit famëmadh "Fe e Atdhe", shpërfaqë veprimtarinë e shumanshme, të spikatun e të efektshme të këtij prelati jo të zakonshëm në këto dy dimensione. Por në ndryshim nga përmasat e të tjerëve klerikë, jo pak të shquem si veprimtare e patriot, përmasat e veprimtarisë dhe e kontributeve të Doçit janë të një vlere sugjestionuese, pa frikë të themi të veçanta dhe vështirë të krahasueshme.

Evidentimi i tipareve të karakterit të Doçit ka tërhequr ndjeshëm vëmendjen e angazhimin e autorit. Ai me të drejte i asht perkushtue në mënyrë të veçante këtij synimi. Informacioni për Doçin nis nga autori që nga bazamentet e racës, mendjes së holle e të mprehte që natyra i kish fale, edukimit shkollor plot virtyte e dituni. Ajo rritet në vazhdimësi, përmes gjithë rrugës së formimit e të konsolidimit të tipareve të tij të karakterit, dhanë këto në një kreshendo gjithnjë në rritje, kushtëzue e favorizue nga situatat delikate e plot peripeci ku shtegëton jeta e Abatit e nga përballjet e tij të sukseshme me to. Aty, krahas pamjes së hijshme e autoritare, zanit kumbues e elokuencës

tërheqëse që të impononte kureshtje, interese e besim, naltohet para nesh forca e karakterit, vendosmëria e konsekuencia, udhëheqja nga qëllime e synime të mëdha e të shenjta të lirisë e pavarësisë së popullit e vendit të vet. Këto cilësi e virtyte prej elite fetare e nacionale, politike e shoqnore, iu kthyen Doçit në pika reference në të gjithë jetën e tij, në gjithë luftën e përpjekjet me realizue qëllimet fisnike e atdhetare para të cilave, me qartësinë e mendimit, me trimni e guxim, me zjarr pasionant shpirti kryengritës, nuk u tërhoq për asnjë çast, as kur për këto u denue dy here me vdekje nga pushtuesit osman. Në të gjithë këtë horizont zhvillimesh Doçi rezultoi "palce Mirdite", thelb shqiptar, frut evropian. Për gjate gjithë veprës voluminoze autori na jep qarte, mire, bukur e besueshëm në veprim modelin përfaqësues të figurës së perkushtueme të Doçit, tue


aparati të gjane e të pasun burimesh informacioni, çka flet për një pune të ngulun, serioze e të vlerësueme të autorit. Vlera të veçanta në këtë drejtim përmajnë të dhanat historike që u referohen burimeve arkivore të arkivit të Vjenës, të konsullatës saj në Shkodër, asaj franceze, të arkivit të Propogandës Fide, arkivit të Shtetit Shqiptar, që rrisin autoritetin shkencor të punës studimore. Burimet krijojnë një baze faktologjike serioze, përmes së cilës marrin shkas e realizohen nga autori në veprën edhe analiza të sakta të situatave, vendimeve, veprimeve e qëndrimeve të Doçit, disa here origjinale e në përballje me ndonjë autore pararendës. Në të gjithë këtë informacion evidentohet edhe një galeri e tanë figurash historike, atyne të klerit e të marrëdhënieve të Doçit me to. Shquhen ma tej kuvende e vendime të randësishme historike, ngjarje, zhvillime, situatë e lufta, mbështete të gjitha këto në prova serioze faktesh e në konfirmime vlerësimesh të Doçit nga figura me emën në histori. Asht një pune kambëngulose hulumtuese kjo e autorit, me durim e eksploratorit e arkeologut, pune e mundimshme prej punonjësi shkencor të ngulun, pasionant e të perkushtueme, me durim prej murgu e me përgjegjësi e vlerësim prej misionari patriot, me dashuri të madhe për vlerat e spikatura të Doçit e për perkushtimin e popullit të një krahine me kaq shume histori si Mirdita. Mund të shprehemi pa frike se vepra asht kontribut i randësishëm i autorit për Historinë e Shqipërisë. Vlerat e saj kane force me diktue rishikimin e pasqyrimin ma të plotë të kontributeve të Mirditës e të prijësve të saj në historinë shqiptare.

Figura e Doçit asht figura shumëdimensionale e një rilindasi të madh. Nëse asht pohue se Rilindja Nacionale Shqiptare naltoi figura shkrintaresh të mëdhej të Rilindjes në luftën e tyre me pene dhe ata të prijësve luftëtare me pushke, në figurën e Doçit shkrihen në një mendimtar i penës me prijësin luftarak me arme, që ia kushtoi gjithçka kësaj lëvizje. Jo rastësisht Ismail Qemali u shpreh: "Ne e bëmë këtë vepër të rëndësishme, por akoma edhe më mire do ta bënte këtë Doçi".

E gjithë kjo pune serioze duhet të kishte nga autori shume ma tepër vlerësime e punës se korrektorit letrar e gjuhësor. Gjithsesi, me këtë monografi me flete të tana historie, Doçi hyn ngadhënjyes në panteonin e historisë shqiptare, tue u shndërrue në shembullin virtyti të udhëheqësit të perkushtueme shpirtnor, politikanit largpamës, organizatorit e administratorit të virtytshëm shtetarit të ndershëm që dishmojnë virtytet tona etnike, vlerat tona nacionale në një areal shqiptar e evropian.

Për suksesin e kësaj vepre, autori Martinin meriton përgëzimet e urimet më të mira!

Përgatitë nga Marian Zef Shestani



ruajtë saktësinë e qartësinë e procedimit në vepër e tue tregue kështu aftësi prej njeriu të sprovueme në këtë zhanër të shkruemit, si autori i disa veprave monografike, e tue realizue kështu për Doçin një monografi dinjitoze, me shije historike e shpesh edhe ma kahje e vlera artistike. Rrëfimi në vepër asht i rrjedhshëm, tregues i një aftësie ët sprovueme. Shpesh mvëshë me një gjuhe të zgjedhun e me forcë emocionuese, shprehje pasunisht të figurshme, plot mendim e elegance, ("Oroshi, vend i vogël, ku vdekja nuk asht asgja krahasue me nderin..."; "... Vriste mendjen për të kuptuar shkaqet pse shqiptari dashurinë dhe urretjen, i ka në shkallen ma të lartë, pse për miqësinë ka një kult të dhimbshëm besnikërie që i reziston çdo prove, pse banoret e këtyne maleve hijerande ekzaltohen lehte dhe frymëzohen shpejt nga ideja e madhështisë dhe shkojnë buza gaz drejt vdekjes" e tjera e tjera).

Vepra për Prend Doçi shquhet për një

Jetmir Podgorica: Si u bëra arbitër!

Kush është Jetmir Podgorica?! Si lindi pasioni yt për arbitrimin; ne ç'moshë ndodhi kjo?

Jetmiri është një djalë shkodran, 17-vjeçar i lindur dhe i rritur ne qytetin e Shkodres. Arbitrimin e kam filluar qe ne moshën 13-vjeçare. Se pari e fillova me futbollin ku u aktivizova me ekipin "Shkodra" qe mbahet si me i miri edhe sot nen drejtimin e trajnerëve TAIP e RUDI PIRANIQI. Gjate kësaj kohe me lindi dëshira për arbitrim duke pasur orientimin , përkrahjen e mbështetjen e dajës tim DRITAN SALAJ, qe aktualisht është Kryetari i Kolegjiumit te Shkodres. Atë e kam pasur dhe e kam idhull, jo vetëm qe ishte arbitër me FIFA-n, por për çdo gjë qe flet e bën ne jetën e përditshme. Ne te gjitha ndeshjet kudo, qe arbitronte me merrte gjithnjë me vete e as unë nuk ngurroja qe t'i shkoja pas. Veç kësaj familja ime ka pasur gjithmonë lidhje me sportin, sepse gjyshi im ZYHDI PODGORICA ka qene shef llogarie ne Klubin "Vllaznia" , ndërsa babai im MENTOR PODGORICA ka punuar kuzhinier po aty.

Duke iu referuar moshës tende te re si i mposhte vështirësitë për t'ia dale mbanë ne vazhdim?

Është e vërtete qe kam pasur vështirësi. Asgjë s'ka qene e lehte, ngaqë isha vetëm 13 vjeç dhe me qëllonte te arbitroja lojtaret, ne Kategorinë e Dyte, si arbitër i katërt. Kisha pak frike se mos gaboja ... dhe shume emocione, sepse 19-vjeçare ishin dy 'krena' me te gjate se unë ... megjithatë është përkushtimi, studimi e njohja e mire me rregulloren, te cilat bene qe t'ia dal mbanë. Rol luajti edhe mbështetja e përvoja e arbitrave te Kolegjiumit si: AGRON KASTRATI, PAJTIM LAPI, MARIAN QESTERI, MELIS DERVISHI, SONIL ZEKA, SAJMIR AMETI.

Si është natyra e një arbitri ne jetën e përditshme?

Arbitri duhet te krijojë një figure te veten, një personalitet te tijin duke qene kështu një tip serioz, i durueshëm, i matur, i drejte dhe i sakte mbi te gjitha i përgjegjshëm si ne fushe ashtu edhe ne jetën e përditshme. Arbitrit nuk i shkon një veshje ekstravagante, një sjellje e pahijshme. Arbitri duhet te kujdeset për veten kudo qe te ndodhet ne te gjitha aspektet e jetës dhe te jete i model për te tjerët, te adhuroje dhe vlerësoje virtytet e te urreje veset.

Përgatitja fizike duhet te jete e njëjte me atë te një futbollisti apo kjo nuk ka edhe aq rëndësi?

Përgatitja fizike e arbitrit është shume e rëndësishme. Nëse ne do te krahasonim një arbitër shume te mire me një futbollist shume te mire, arbitri ka përgatitje fizike shume me te madhe se futbollisti dhe jam i sigurte për ketë, pasi një arbitër kryesor duhet te vrapoje ne fushe për 90 minuta dhe te vëzhgojë lëvizjet e lojtareve. Pastaj 4 here ne vit janë normat teorike dhe fizike pa te cilat nuk mund te arbitrosh.

Gjithë kjo përgatitje fizike kërkon

edhe një ushqyerje me te pasur mendoj; ne rastin tënd është e domosdoshme një ushqyerje specifike apo nuk i kushton rëndësi këtij aspekti?

Patjetër qe i kushtohet rëndësi ushqimit, marrja e vitaminave te nevojshme te ndihmon ne përgatitjen fizike. Për ushqimin kujdeset vëllai im LEARTI, i cili gatuan vetëm për mua dhe e bën shume mire ketë gjë. Ai është një MASTERCHEF i vertete. Përveç kësaj ai me shoqëron kur unë vrapoj ne darke vone apo ne mëngjes herët para lindjes se diellit.

... meçe dole tek familja; ç'rol luan ajo moralisht dhe financiarisht për aktivitetin tënd sportive?

Për mua: FAMILJA ESHTË E SHENJTE!!! Falënderoj Zotin qe jetoj ne një familje ku mbizotëron dashuria, paqja, mirëkuptimi, ngrohtësia e respekti për njeri-tjetrin. Familjen e kam pasur mbështetjen kryesore morale e financiare ne te gjithë veprimtarinë time ne lidhje me sportin. Morale e financiare, nuk mund te ndaj sepse me është përgjigjur ne fillimet e mia kur me është dashur një udhëtim, kostum i përshtatshëm, këpucët sportive, një bilbil i mire apo flamuajt, rrobat e shumta, te lara e te hekurrosura ... përcjelljet nga nëna ESMA e gjysh AGIMI e mbi te gjitha pritjet e gjata ne orët e vone te nëna BALIT, ne oborrin e shtëpisë dhe sytë e mamit qe shkëlqejnë duke me uruar mirëseardhjen. Familja te jep kuraja për te realizuar çdo iniciative... po ashtu edhe shoqëria pasi ne shume ndeshje dhe aktivitete sportive ka qene e pranishme. Kjo te bën te ndihesh mire.

Cilat kane qene ndeshjet me te rëndësishme apo finalet qe ti arbitrove dhe dëshmove cilësitet e tua te mira ne arbitrim?

E kam filluar me U 11-ën, U 13-ën, U 15-ën, U 17-ën e tani ne Kategori te Dyte! Deri sezonin e fundit kam arbitruar 189 ndeshje... qe është një shifër rekord, për moshën time. Te gjitha kane qene te rëndësishme, por duhet te përmend ndeshjet qe janë zhvilluar ne France e ne Gjermani ku kam arbitruar, si asistent, moshat 15-vjeçare (lojtare me te rritur se unë). Emocionues e mbresëlënëse është gjykimi i ndeshjes Vllaznia-Zeta (Mali i Zi), ku për here te pare kane marre pjese 6 arbitra dhe unë kam qene njeri prej tyre. Një kryesor, dy asistente, një i katërt dhe dy pas portave. Konkretisht: DITMAR JUBICA, DRITAN SALAJ, GJOVALIN BORI, INDRIT MYRTJA, NIKOLIN STERKAJ dhe JETMIR PODGORICA. Kjo ishte një risi qe e solli Kolegjiumi i Shkodres, por jemi mësuar për te sjell risi dhe nuk na beri shume përshtypje pasi ne kemi sjelle te paret futbollin ne Shqipëri, kemi arbitrin e pare te FIFA-s ne Shqipëri, LUIGJ SHALA, ndaj s'kishim pse te befashoheshim!!! Qe nga viti 2012-'13-'14 kam arbitruar si asistent ne shume

ndeshje e finale mes komunave, ne finalet e Ligës Amatore këtu ne Shkodër. Moralisht ndihem tepër i vlerësuar për arbitrimin e kampionatit Dioqezian ndërmjet Dioqezave te fshatrave,ku arbitrova ne finale kohet e fundit duke marre çmim dhe medalje. Medalje te tjera kam marre edhe për arbitrim ne Kampionatin Pranveror mes shkollave te mesme te qarkut te Shkodres te viteve 2012/'13 /'14, po ashtu kam arbitruar ndeshjet e Qendrës Don Bosko e shume ndeshje te tjera femrash e te moshave te ndryshme. Gjithsesi mbetem arbitri me i ri ne moshe qe arbitroj ne Kategorinë e Dyte saçe futbollistet mendonin: "si do te na arbitroje ky fëmije"!..., por ne fushe dhe pas ndeshjes mbeteshin te kënaqur gjithnjë. Kam pasur ndeshje te Kategorisë se Dyte qe ishte vendi i parafundit me atë te fundit, ku humbësi ishte 99 % i rene nga Kategoria. Kam arbitruar edhe vendin e pare me vendin e trete duke pasur secila ndikimin e vet persa u përket pozicioneve te tyre brenda Kategorisë. Këtu shihet vlerëshmi edhe besimi, qe te jepet, por me tepër përgjegjësia qe duhet te kesh.

Si e shpenzove kohën e lire gjate këtyre pushimeve verore? I kushton vëmendje internetit ashtu si gjithë moshataret e tu dhe për ç'fare konkretisht? Diçka me tepër për Jetmirin ...

Ne shtëpinë time gjendet biblioteka familjare e trashëguar dhe qe pasurohet çdo dite ... Lexoj vepra te Fishtës, Koliqit, Mjedës, Migjenit, Konicës, Kadaresë, Dante, Shekspir, Balzak, Markez e te tjera. Ne dhomën teme gjenden libra e revista e CD te shumta qe lidhen me futbollin dhe arbitrimin. Aty gjendet flam-

e shtëpisë... Me shume kohe dhe me te bukuren e kaloj me vëllanë tim LEARTIN, kuptohet gjate e përtej kohës se lire... sepse ai është "kuzhinieri", "truproja", "menaxheri", "zedhenesi" "sahati me zhavarine", "fansi", "trajneri" personal i imi. Ne internet marr informacion te ri ne lidhje me rregulloren apo shoh situatete ndryshme arbitrimi.

Kam dëgjuar te thuhet qe arbitri ka edhe fatin e ndeshjes ne dore... është e vërtete kjo?

Fati i ndeshjes qëndron tek dy ekipet, tek loja e tyre... Arbitri është për te dhënë vendimin e tij ne rastet ne kundërshtim me rregulloren por ai nuk mund te shënoje golin ... edhe ne ndonjë rast gabimi ne vendim është vëzhguesi i cili vlerëson arbitrin (për rastin konkret) sa i përket gjykimit ne fushe.

E ndoqe Botërorin 2014? Te beri përshtypje ndonjëri prej arbitrave te këtij rangu sa i përket gjykimit? Përfitove nga ato?

Po e ndoqa... Arbitri im i preferuar i rangut botëror është Howard Webb, i cili gjate transmetimit te një ndeshjeje te gjithë shohin lëvizjet e futbollisteve, ndërsa unë shoh lëvizjet e arbitrit...: si vepron, si pozicionohet ne fushe, si komunikon me lojtaret etj ... Ky ka qene një arbitër për mendimin tim me i miri sa i përket gjykimit te rasteve ne shume ndeshje për 25 vitet ne te cilat ai ka arbitruar.

Duke pare përkushtimin qe ke ndaj arbitrimin,duke iu referuar arritjeve te deritanishme...ku e shikon ti Jetmirin pas 5 vitesh? (po ndonjë dëshire qofte edhe pas 55 vitesh...)

Nëse punët do te shkojnë mire dhe ashtu siç e kam menduar unë bashke me profesorët e mi, pas 5 vitesh mund te them pa frike se mund te jem ne Kategorinë Superiore. E pasi ta kem arritur ketë (kam edhe unë pretendimet e mia) qe te piqem gjithnjë e me shume për te arritur majat e arbitrimit me marrjen e stemës se FIFA-s, te cilën tani e kam ëndërr. Dëshiroj te le emër te mire ne historinë e sportit shqiptar (pas karrierës) ashtu si: SKENDER BILALI, TAHIR KALACI, MEHILL SHKEMBI, ASTRIT DERVISHI, ASTRIT ISUFI, te cilët janë te nderuar, te

vlerësuar e te respektuar nga te gjithë. Ndërsa pas 55 vitesh serish me familjen, farefis, shoqëri e dashamire... me Besim shendosh e mire e zemerplot, i lumtur e faqebardhe... duke i pare njerëzit ne sy, pa e ulur kokën para askujt... Duke mbajtur e trashëguar kulturën, traditat, dijen, bujarinë, mirësjelljen, qytetarinë e emrin e respektuar te familjes Podgorica, nder me te vjetrat e qytetit tone qe gjithnjë ka lindur, ka edukuar, rritur e arsimuar bij e bija me urti e nder.

Duke përfunduar, Jetmiri i urojme suksese te mëtejshme ne karrierën e arbitrimit, një vit te mbare shkollor dhe e presim me arritje te reja ne intervista te tjera.

Faleminderit juve për ketë bashkëbisedim te këndshëm!

Intervistori Rudina Bardhi



Në kërkim të fakteve dhe shtrimi i hipotezave

TRYEZË BASHKËBISEDIMI NË TUZ

Ditën e premte, me 31 tetor 2014, në ambientet e hotel "Liria" në Tuz u bë një takim miqësor mes intelektualësh, në funksion të një hulumtimi shkencor. Fshati Gjuraraj, i cili është objekt hulumtimi për një studim shkencor të z. Ndue Sanaj, kryetar i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", u bë shtysë për organizimin e kësaj tryeze bashkëbisedimi. Në këtë takim morën pjesë z. Lucë Lulgjuraj, z. Kolë Lulgjuraj, z. Marjan Lulgjuraj, z. Demi Ferlushkaj, z. Sabrudin Ferlushkaj ndërsa nga Shkodra ishin në këtë tryezë: z. Ndue Sanaj, z. Arben Gjuraraj dhe znjsh. Arjeta Ferlushkaj.

Koordinues i këtij takimi ishte z. Marjan Lulgjuraj, mësues i gjuhës shqipe në gjimnazin e Tuzit "25 Maji". Fjalën e hapjes si dhe atë të përshëndetjes e mbajti z. Lucë Lulgjuraj, ish-arsimtar, i cili përgëzoi nismëtarët e këtij takimi dhe uroi mirëseardhjen e grupit nga Shkodra. Me rëndësi në këtë takim ishte jo vetëm mbledhja e burimeve dhe informacioneve të duhura mbi rrënjët e emrit "Gjuraraj", "Lulgjuraj" apo kalimi nga Lulgjuraj në Ferlushkaj e te tjerë, çështje të cilat u diskutuan nga të pranishmit, por më së

shumti ishte shtrimi i hipotezave. Secili nga të pranishmit solli variantin e vet, të trashëguar nga të parët e tyre brez mbas brezi. Gjithashtu, e rëndësishme në këtë takim ishte ballafaqimi i këtyre varianteve

sepse vetëm puna në grup bën të mundur që, përmes fakteve të qëndrueshme, të hidhet sa më shumë dritë mbi objektin e studimit. Bashkëbisedimi zgjati më shumë se një orë. Në fund, të pranishmit

u mbledhën për të shkrepur fotot e rastit dhe falënderuan z. Safet Ferlushkaj për mikpritjen dhe mbështetjen e dhënë për mbarëvajtjen e këtij takimi.

Nga Arjeta Ferlushkaj



Nga historia shqiptare e Anadollit dje...

(vijon nga nr. 131)

Sami Frashri na bën me dije për ngulime të tjera shqiptare në Thrakë dhe në brigjet e Detit Marmara si dhe në ishujt afër tyre. Këto komunitete shqiptarësh ortodokse u dëbuan në Greqi pas Luftës së Parë Botërore, në periudhën e shkëmbimit të popullsisë midis dy vendeve (turqisht "mubadele" dhe greqisht "andallia"). Nuk është fjala për "Adalar" (Ishujt e Princave) që janë në Grykën e Bosforit në Stamboll, përballë Kadiqojit, gjithsej 9 ishuj të banuar e të pabanuar, me popullsi ortodokse, që s'u përfshinë në marrëveshjen e shkëmbimit që u nënshkrua në Lozanë të Zvicrës. Popullata ortodokse e Stambollit nuk u prek nga ky traktat ogurzi për shqiptarët. Sasia më e madhe e shqiptarëve të Turqisë është grumbulluar në pjesën evropiane të saj.

Së dyti: Rajoni i Bursës me sipërfaqe 11 087 km² dhe popullsi prej 2 600 555, pra gati sa Kosova e sotme. Bursa është qyteti i katërt më i madh i Turqisë. Në këtë rajon përfshihen edhe qytetet si Adapazar, Kutahja (emri i vjetër Qytahja) Bandërmaja, Ballëkesiri, Çanakala e deri në Ajvallëk, një qendër e vogël e banuar buzë Detit Egje. Brenda qytetit Bursa (thirret edhe Brusa) ka disa mëhalla si "Zafer" e të tjera plot e përplot me shqiptarë, ku shqipja gjallon deri në ditët tona. Kjo lagje njihet si lagje e shqiptarëve. Ata kanë shoqatat e tyre kulturore-artistike dhe janë të mirë-organizuar. Ka shqiptarë të hershëm si ata

të Nishit që i gjen në qytete si Adapazar, Kutahja e të tjerë. Shqiptarë ka dhe Bandermaja, Ballëkesiri, si dhe rajonet bregdetare, por me klimë relativisht të ftohtë si Çanakala apo diçka më ndryshe Ajvallëk, Akçaj e të tjerë. Ka dhe ishuj si Bozxha Ada apo ndonjë tjetër në krah të saj të banuar nga të krishterë shqiptarë të vendit, të ashtuquajtur rumë. Prej këtyre ka dalë dhe patriarku ortodoks aktual i Stambollit, Bartolemeo, që e di shqipen si gjuhë amtare që e ka ... Banorët e ardhur janë kryesisht nga Kosova e më pak nga Maqedonia.

Së treti, është Rajoni i Izmirit me qytete si Manisa, Akhisar, Ajdin, Denizli, Fethije, Marmaris, Bodrum e deri në Antalja e Alanja, duke përfshirë dhe Ispartën dhe Afjonin e të tjerë. Ky rajon është i mbushur plot e përplot me shqiptarë të Çamërisë që erdhën pas nënshkrimit të Traktatit të Lozanës në vitet 1923-25. Qyteti i Izmirit lagjen e vet më të madhe e më të rëndësishme, lagjen aristokrate të vet, Karshejaka, në 90% të saj i ka me shqiptarë të Çamërisë apo dhe Janinës. Po nuk mungojnë dhe shqiptarët e Kosovës, p.sh. nga Prishtina, të Shqipërisë e të Maqedonisë. Në lagjet e Izmirit apo Smirnës së dikurshme, është folur shqip nga rumët shqiptarë të këtij qyteti dhe pastaj pas dëbimit me marrëveshjen e Lozanës të shqiptarëve ortodoksë, këta u zëvendësuan me shqiptarë myslimanë të Çamërisë, me shqiptarë fisnikë myslimanë arvanitë të krahinave të Manit e të Lalës në Peloponez (More).

Po ashtu Izmiri pas 1924-1925 u mbush me kosovarë të ndjekur nga regjimi serbomadhi i Krajlit, Aleksandër Karagjorgjeviç. Pra shqipja është dëgjuar deri në fund të shekullit XX në lagjet e Izmirit e ku më shumë e ku më pak, ndonëse më rrallë, sot vetëm në mjediset familjare. Çamët jetojnë të tubuar në qytete të tilla, veç Izmirit, si Foça, Menemen, Manisa, Soqe, Selçuk, Ajdin, Denizli e më pak në Bodrum, Fethije, Marmaris apo Muglla. Është për t'u përmendur një fshat i madh apo qytet i vogël, jo larg nga Izmiri, me emrin Jeniqoj me shqiptarë të Kosovës që flasin edhe sot e kësaj dite shqip e vetëm shqip. Njeriu mendon se është në Kosovë apo Shqipëri. Shqiptarë të Kosovës dhe Maqedonisë ka në qendrat e banuara në veri e në verilindje të Izmirit, siç është Aksaraj e të tjerë. Ka dhe rajone që janë të përziera me shqiptarë të ndryshëm, të Kosovës e të Çamërisë, siç është qyteti Akhisar e qendra të tjera më pak të njohura. Janë fshatra të tëra që deri vonë kanë folur shqip, por proceset urbanizuese kanë bërë punën e vet. Antalja, Alanja dhe qytete të vogla në krah të tyre, buzë detit si Qemer, Manavgat, Side etj. kanë shqiptarë të ardhur e të vendosur në to në kohë të ndryshme. Shifra për numrin e tyre s'ka, por kur pyet shqiptarët e atyshëm të thonë se janë shumë, "pa hesap"!

Së katërti, kemi Rajonin e Anadollit Qendror apo të Ankarasë, ndryshe mund ta quajja edhe të kryeqytetit turk. Në të përfshihen veç kryeqendrës së

Turqisë po edhe të Anadollit Qendror e përgjithësisht të Ankarasë dhe qytete të tilla si Jozgat, Konja, Kajseri dhe Nigde, si dhe qytetin e Haxhi Bektashit si qendër e bektashizmit. Ankaraja si çdo kryeqytet ka mbledhur edhe shqiptarë nga të katër anët e Turqisë dhe numri i tyre që banojnë në të është i konsiderueshëm.

Shqiptarët i gjen kudo në tërë poret e jetës turke, sidomos në poste drejtuese e komanduese si në aparatit shtetëror, në ushtri, në polici, në ekonomi, industri e tregti, në arsim dhe kulturë dhe ata gëzojnë respektin e mbarë popullsisë. Të përmendësh emrin shqiptar në Turqi, si dje dhe sot, është sikur të përmendësh një emër të shquar, të nderuar, me reputacionin më të mirë që mund të bëhet. Në tërë shtresat e popullsisë, pavarësisht nga niveli shoqëror apo raca dhe në gjithë popullsinë e Republikës Turke, s'ka rëndësi përbërja etnike e saj, të thash "arnaut" d.m.th. të kujtosh një emër me peshë të madhe, njerëzore që gëzon një respekt jo të zakonshëm. Nuk duam të zgjatemi në këtë pikë se do të shkonte gjatë ky shkrim.

Popullsia rume e Kajserit, e Konjës apo dhe e qyteteve e fshatrave të tjera të Anadollit Qendror me marrëveshjen e Lozanës u vu në rrugën e ikjes drejt Greqisë. Boshllëkun e tyre e mbushën çamët e Çamërisë dhe shqiptarët e Maqedonisë "greke" deri në qytetin e Mersinit në bregdetin e Mesdheut. Nga këto vise është shkrimtari, poeti e dramaturgu i njohur turk me origjinë shqiptare Nexhati Xhumali prej Follorine që vdiq tani së voni, pas viteve 2000, në Turqi. Viset e Jozgatit kanë të ardhur më shumë çamë kurse Kajseri, Konja, Nigde dhe Haxhi Bektashi etj. kanë shqiptarë nga Kosova, më pak nga Maqedonia, po diku dhe shqiptarë të ardhur herët nga Shqipëria, kryesisht nga jugu i saj. Diku fare pranë qytetit të Haxhi Bektashit janë dy fshatra

shqiptare ku ende edhe sot flitet shqip, siç na kanë bërë të ditur dëshmitarë okularë.

Së pesti kemi Rajonin e Adanasë apo të Juglindjes me qytete të tilla si Adana, Mersin, Iskenderun etj. që shtrihet kryesisht në një nga fushat më pjellore të Turqisë, të Çukurovës nën malet Toros, vargmale që përshkojnë tej për tej Anadolliin. Aty gjen shqiptarë nga tërë trevat e Ballkanit, të trojeve etnike shqiptare, po edhe çamë. Autori i këtyre rrjeshtave ka takuar në një qytet të vogël, Dortjoll, të përfshirë në qarkun Osmanije, afër Iskenderunit, çamë të Pargës dhe të zonës së Igumenicës. Në këto anë janë dy fshatra me shqiptarë të Kosovës, të dëgjuar në tërë Turqinë si Naxhar i Madh dhe Naxhar i Vogël, ku flitet sot e gjithë ditën shqip, të dy bashkë, me disa mijëra banorë. Këto emra të vjetër të këtyre fshatrave sot janë ndërruar, po shqipja vazhdon të dëgjohet edhe në këto anë të Anadollit. Çudia e autorit ishte, kur mësoi për ekzistencën e një a dy fshatrave shqiptare pranë kufirit me Sirinë, në zonën e qytetit Antakja apo provincës Hataj siç thuhet ndryshe, e cila dihet hyri në përbërje të Republikës Turke me referendumin e vitit 1938.

Së gjashti kemi Rajonin e Detit të Zi, apo Karadenizit (siç i thonë turqisht), kryesisht me qytetet e Samsunit, Amasjas, Sivasit, Bafrës po dhe të Sinopit e të Çankërës... Këtu ka kryesisht shqiptarë të ardhur në vitet 1877, 1878 nga qyteti dhe rajoni shqiptar i Nishit apo siç thirrej dikur Sanxhaku i Nishit, sot i mbetur nën Serbi. Janë me dhjetra mijëra, mos them qindra mijra shqiptarë që jetojnë në fshatra me masa kompakte si dhe në ndonjë qytet si Bafra që mund të quhet pa frikë qytet shqiptar. Janë për t'u përmendur shqiptarët e qytetit të Tokatit e të rrethinës së tij. Të gjithë ata që shinin simite rrugëve të Stambollit me karruca ambulante ishin nga këto anë dhe kudo midis tyre ata flisnin shqip. Ata ishin shqipfolës të çartur, ndonëse disa breza kishin lindur e rritur në Turqi dhe në fshatrat e tyre flitej shqipja e patrazura. Kur vinin në Stamboll në punën e tyre si simitshitës atëherë fillonin të mësonin turqisht. Shqiptarë të çuditshëm, asht i pandryshueshëm i tokës arbëreshe. Të përkulëm në gjunjë dhe të falem ty o gen i tokës mëmë që di të mbijetosh dhe i pashkolluar, siç ke mbijetuar në shekujt vstararë e të pamëshirshëm e në kohërat "njerë" për Shqipërinë e kombin shqiptar! Shqiptarët e këtyre anëve jetojnë në një gjeografi që përfshin qytetin e madh bregdetar të Samsunit, kryeqendër e Vilajetit me të njëjtin emër me mbi 1 milion banorë, në Sivas, në Amasja e Tokat po edhe në Sinop e Çankere. I gjen ata dhe në qytetet e Bollusë e të Zonguldakut si qendër minerare e metalurgjike e vendit, në Kastamonu etj. Fusha e Samsunit, ku rritet sidomos duhani e deri poshtë në thellësi të Anadollit zbukurohet edhe me qeleshet, plisat shqiptarë. Sado që ka kaluar gati një shekull e gjysmë nga dëbimi i tyre prej trojeve amtare, shqipja ruhet edhe në këto anë në thellësi të Turqisë. Këta shqiptarë të Nishit përbëjnë një kapitull të veçantë të mbijetesës së racës shqiptare në këto anë. Një autor i Kosovës u ka kushtuar një monografi të tërë këtyre shqiptarëve me trup si lisat e bjeshkëve të tokës Arbënore dhe me pasuri shpirtërore të

jashtëzakonshme, palcë e shqiptarizmit që bartën kudo që shkuan genin e shqiptarit. Ata i dhanë emrit shqiptar përmasa dhe vend të veçantë, që s'guxon ta zërë kush në Republikën e Turqisë. Nderim e respekt të pamat këtyre burrave të kombit shqiptar dhe nënave shqiptare që janë krenare për emrin shqiptar e për nënën SHQIPER! Nishi dhe nishjotët kosovarë nuk vdesin kurrë! Ndaj detyrë e dy shteteve shqiptare është studimi i jetës dhe veprimtarisë së këtyre shqiptarëve të "harruar" të Samsunit, nxjerrja në dritë e tyre, ruajtja e gjuhës shqipe dhe përpjekja për moszhbërjen e tyre, duke ngritur qendra kulturore shqiptare, duke hapur panaire libri, duke dërguar grupe artistike-folklorike etj. Janë me qindra fshatra që gjallojnë shqip e si shqiptarë!

Së shtati: Rajoni i popullsisë llaze. Në të përfshihet zona e lindjes së Detit të Zi e banuar nga një popullsi që quhen llazë, në qytete të tilla si Trabzon, Artvin po dhe Ordu e Giresun. Pra, rajoni i shtatë i llazëve në një kuptim të kujton apo ngjet me rivierën shqiptare të Himarë – Sarandës. Aty ke dhe detin e kaltër dhe malin dhe fushën pranë e pranë njëra tjetrës. Kjo popullsi është shumë e afërt në traditë, zakone, konstitucionin shpirtëror me shqiptarët, aq sa dikush prej shqiptarëve apo dhe llazëve thotë se këto dy kombe janë "djem xhaxhallarësh", "kushërinj". Këto i kam dëgjuar në rajonin e Stambollit, të Zejtinburnusë, një nga më të mëdhenjtë, më të industrializuar dhe me më perspektivë të qytetit të stërmadh, gjysma e të cilit banohet kryesisht me shqiptarë të Maqedonisë e gjysma nga llazë të Detit të Zi. Duke dëgjuar turqishten e të dy palëve, që nuk i shpëton aksentit të gjuhëve përkatëse, të duket sikur po dëgjon turqishten e Prizrenit të Kosovës, të konservuar nga osmanishtja, turqishtja e vjetër, sidomos me theksimin e germës xh (c) dhe eliminimin në shqiptim të rrokjeve të fundit psh të formës së kohës së ardhshme: "do të vij" – "gel-exhehim – gelexhem". Koha kërkon dhe kushtet janë krijuar, me botimet gjithnjë e më të shumta edhe në këtë gjuhë, pak të lëvruar siç është gjuha llaze – llazishtja – të bëhen nga gjuhëtarët tanë studime krahasuese e pse jo dhe gramatika e fjalorë në të dy gjuhët. Atëherë do të dalë në shesh se sa të afërt me njëri-tjetrin janë këta dy popuj, që në Turqi i konsiderojnë si "kushërinj" dhe sa përkime e gjëra të përbashkëta e bile të njëjta ka në gjuhët e tyre, në veshjen e tyre, në traditat, zakonet, në historinë e tyre. A ka shqiptarë të vajtur në Trabzon, Artvin, Hopa e qytete të tjera më të vogla llaze? Ka, relativisht pak, si në historinë e largët e të afërt si dhe sot. Gjithmonë janë shkrirë e bërë njësh me popullsinë vendase llaze, janë martuar aty e përthithur nga mjedisi llaz. "Kan çeker" – "tërheq gjaku", thonë turqit e në këtë rast kjo vlen midis shqiptarëve dhe llazëve. Ngjasin në fjalët e urta, në shakatë e tyre e në se nuk ngjasin! Nuk mund t'i shpjegosh kollaj këto përngjasime kaq të mëdha. Kërkojnë studime të posaçme që unë kam bindjen që koha do t'i sjellë, bile më shpejt se sa mund të mendohet. Llazët, gjaku ynë pel-lazg nuk mund të zhduket kurrë!!! Zoti e ka ruajtur deri në ditët tona! Dhuratë e papërsëritshme! "Kan çeker", po po "kan çeker". Gjaku s'bëhet ujë po dhe n'u bëftë s'piket... Me llazët është marrë, sidomos

me gjuhën e tyre një shkencëtar, një gjuhëtar i shquar i ish-Bashkimit Sovjetik N. Mari i cili kritikohet direkt nga Stalini, në veprën e tij "Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë".

Së teti, Rajoni i fundit kurd. Ky përfshin viset e Anadollit të brendshëm lindor me kryeqendër qytetin e madh të Diyarbakërit (ose Diyarbeqirit) me qytete të tjerë si Gaziantep, Marash, Urfa, Malatia, Tunxheli, Elazig, Van, Mush, Siirt etj. të banuar kryesisht nga kurdët po dhe turqit. Rajoni kurd dhe ai llaz nga pikëpamja që po flasim d.m.th. për vendndodhjen e shqiptarëve, janë dy rajonet më pak të rëndësishëm. Këtu në këtë zonë ka shqiptarë të turqizuar të sjellë në kohën e Ataturkut që janë nga ish Vilajeti i Selanikut apo dhe Gjiriti, siç i thonë turqit ishullit të Kretës në Detin Mesdhe. P sh autorit i këtyre radhëve, i ka njohur të tillë "shqiptarë selaniklinj", të vendosur në rrethinat e qytetit Elazig, me traditë, zakone etj. si shqiptarët e krejt Toskërisë. Vetëm ishte bjerë gjuha shqipe në brezat e rinj. Sigurisht nga pikëpamja sasiore në pjesën e Diyarbakërit, sidomos nëpër qytete, (Ataturku i vendosi këta emigrantë nëpër fshatra, u dha tokë, shtëpi, gjë të gjallë e katandi) numri i shqiptarëve është shumë më i madh se në brigjet e Detit të Zi.

Do t'i mbyllja këto rreshta duke iu drejtuar dy shqiptarëve në Turqi, njërit nga Dibra e tjetrit nga Kosova, nga Prizreni. I pari është filozof i mirënjohur në Turqi, Riza Tefik Dibrani, i cili shkruan se "kombi fisnik shqiptar i ka dhënë Perandorisë Osmane e më pas Republikës së Turqisë me dhjetëra e qindra njerëz të mëdhenj që lartësuan emrin e Turqisë në Evropë dhe në botë, përfshi këtu një Hoxha Tahsin, një Shemsedin Sami Frashri e të tjerë". Së dyti është shqiptari i Prizrenit e miku im, atdhetari i shquar Ibrahim Ikiz (Binaku) që dhe fëmijëve të vajzës së vet ua vuri emrat Naim e Besa. Ai më ka treguar se "nga 27 kombet që jetonin në Perandorinë Osmane, në krye të tyre dhe me statusin më të lartë (qëndronin mbi turqit e të tjerët) ishin shqiptarët. Ata quheshin kombi "nexhip", që do të thotë kombi "fisnik". Këtë vënd e këtë status e kanë dhe e ruajnë edhe sot Shqiptarët e Turqisë...

Autori i këtyre radhëve, duke menduar të ardhmen, ka bindjen e patundur dhe koha ka për ta treguar e vërtetuar, edhe historia ka për ta shkruar se Shqiptarët e Turqisë janë një potencial i jashtëzakonshëm sasiore (përbëjnë numrin më të madh të shqiptarëve në botë) dhe cilësor dhe si të tillë kanë një mision fisnik të trefishtë (ndonjë segment i të cilit vjen natyrshëm nga shekujt), së pari, të kontribuojnë maksimalisht për vendin ku jetojnë e punojnë, Turqinë; së dyti, të shërbejnë si urë e fuqishme jo thjesht miqësie por vëllazërie midis Turqisë dhe Shqipërisë dhe, së treti, të shërbejnë në një mënyrë ose tjetër si një mbështetje dhe një lloj "leve Arkimedi" për zhvillimin e përparimin e Shqipërisë e të krejt kombit shqiptar, mjafton që vendi amë mos të bëjë indiferentin ndaj tyre siç e ka bërë deri më tani dhe të kujdeset për emancipimin e vazhdueshëm, sidomos shpirtëror, të tyre.

Gazeta "Metropol"
12&13 qershor 2012

MODERATORE DHE IMPROVIZUESE

PORTRET -

Kam shkruar edhe herë të tjera për një televizion lokal të qytetit të Shkodrës i cili hapat e parë nuk i hodhi thjeshtë për biznes, por falë guximit të ideatorit të këtij TV, sot Art Center "Blue Sky" z. Gëzim Brahusa, këto hapa i hodhi në një rrugë të vështirë gati të pashkelur, për pasqyrimin e vlerave të këngës popullore qytetare shkodrane dhe më gjërë.

Duke parë ecurinë dhe rritjen për vite me radhë teknikisht, profesionalisht dhe artistikisht, duke parë nivelin që ka arritur ky TV kohët e fundit në shikushmërinë e tij në një rreze shumë më të gjërë gjeografike, kuptova se brenda ambienteve të tij ka një ekip që i garanton suksesin. Ata janë shumë, që nga prapavia e deri tek ata që prezantohen para kameras.

Unë sot do të veçoj një prej tyre. Ajo është moderatoria simpatike e këtij televizioni, prezantuesja Adelajda Tukiqi. E apasionuar pas letërsisë, gazetarisë, por edhe me një ëndërr të hershme për t'u përballur me mijëra e mijëra shikues përmes ekranit të vogël Adelajda (që të kujton një qytet hyjnor në Australi) mori përsipër që me aftësitë e saj të japë kontributin e vet në mënyrë që TV "Blue Sky" të kthehet në një qendër kulturore jo vetëm lokale, por edhe nacionale.

Hapat e parë ishin bisedat dhe intervistat me përformuesit në këtë TV, të cilët vinin nga trevat e ndryshme shqiptare, që këndonin, interpretonin dhe mbeteshin gati anonim për teleshikuesit. Kush ishin këta? Nga vinin? Cila ishte karriera e tyre? Të gjitha këto që teleshikuesi nuk i dinte i bëri publike për herë të parë përmes TV "Blue Sky" kjo vajzë e talentuar që përmes bisedave „shqiptarshë“ të gjithë këta artistë të mëdhenj na i solli më pranë.

Nga ecuria dhe niveli i jashtëzakonshëm i ndjekësve të TV „Blue Sky“, lindi ideja që në fundjavë në skenën e këtij TV,



tanime me parametra bashkëkohore të formatohej dhe të aplikohet një program krejtësisht i veçantë i titulluar „Eekend vip“, i cili u prezantua për herë të parë në ekran në shtator 2006.

Nga edicioni në edicion ky format njohu vetëm rritje, ku natyrisht një nga meritat kryesore i takon prezantimit të tij në panel, prezantim që tanimë kishte zërin

Shembulli i mirë i mësuesit, suksesi i nxënësit

Festa e Pavarsisë në shkollën Dedë Gjon Luli, u përjetua me shumë entuziazëm në fshatin Hot i Ri. Në vazhden e punës së mirë që po bëhet në këtë shkollë përgaditjet për këtë festë, kishin filluar disa javë përpara ku në drejtimin e mësuesve të kesaj shkolle të cilët dinë të bashkëpunojnë shumë mirë njëri me tjetrin u organizuan konkurse në fusha të ndryshme dhe me tematika të ndryshme. Nxënësit me dëshirën e mirë për të dhënë më të mirën dhe të udhëzuar nga mësuesit u përgaditën shumë seriozisht dhe në fazat konkurruese përgjellja ishte shumë e vështirë pasi paraqitjet ishin në nivelin e duhur. Të organizosh një festë si kjo e Pavarsisë pas një pune shumë të mirë nuk është e vështirë sepse çdo gjë tashmë ishte gati nga përgjellja e numrave fitues si në fushën e fjalës artistike, ashtu në krijimtari, këngë dhe valle.

Duke e parë këtë program festiv me syrin e një profesionisti nuk të ngelej gjë tjetër veçse të shoqëroj në përfundim të çdo numri me fjalët- "Ju lumtë!"- dhe të duartrokisje.

Ne si komuniteti nga zemra i falenderojmë kolektivin e mësuesve të shkollës, e

cila drejtohet nga z. Gjovalin Kodra, i cili ka ditë të ndërthyrë mjaft mirë dëshirën e tij për të bërë diçka të mirë, bashkëpunimin me moshën e fëmijëve tanë. Në këtë shkollë të le shije të mirë bashkëpunim i mësuesve njëri me tjetrin dhe nxënësit. Ata i gjenë të punojnë së bashku me Drejtor Gjovalini në oborr për ta zbuluar, i gjenë të shkruaj dhe interpretojnë me mësues Aimirin dhe Jehonën, të kercëjnë e të këndojnë me mësuese Dranen dhe edukatore Dritën. Të luajnë e të garojnë me mësues Milacin. Këtu nuk ekziston mendimi ky nxënës është i klasës sime, jo aty janë të gjithë të barabartë. Një falenderim për mësueset e fillores dhe të të gjitha lëndve që nuk po i përmendim.

Sa bukur është kur një shembull i bashkëpunimit mes mësuesve jepet çdo orë, ditë dhe javë para syve të fëmijëve tanë të cilët janë e ardhmja.

Falenderimet tona janë për ju të dashur mësues të shkollës "Dedë Gjon Luli" – Hoti i Ri për punën e palodhur dhe shembullin e mirë.

Ju falenderim të gjithëve.

Pergatite Roza Pjetri



REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

dhe performancën e Adelajdës.

Energjike, e qeshur, komunikuese, njohëse e karaktereve, veçorive dhe karrierës artistike të të çdo të ftuari në „Eëekend vip“, Adelajda në çdo edicion sillte diçka të re, të cilën e përcillte në mënyrë profesionale përtej ekranit të vogël. Kjo moderatore simpatike me thjeshtësinë e saj, me zërin e saj dhe pyetjet që formulon jo vetëm e zbuluron ekranin e këtij televizioni, por arrin më së miri edhe qëllimin njohës e edukativ, nëpërmjet një atmosfere të këndshme dhe komode gjatë bashkëbisedimit me të ftuarit e saj, duke i dhënë mundësi atyre që të rrëfehen e ta jetësojnë bisedën, i motivon ata përmes një intonacioni të pastër, të veçantë dhe me shumë profesionalizëm, duke plotësuar panelin me shpirtin artistik, formimin intelektual e pse jo edhe me lukun kurdoherë të veçantë.

Një rëndësi të veçantë kanë tematikat që Adelajda përzgjedh, për nga larmia e rrymave dhe zhanreve që artistët përfaqësojnë, karriera të caktuara, evente artistike, si dhe promovimin e artistëve të rinj. Natyrshmëria në bisedat dhe intervistat që ajo zhvillon plot elegancë dhe origjinalitet është edhe çelësi i suksesit të Adelajdës.

Në këtë cikël emisionesh duhet të përmendim se ajo ka pasur të ftuar në panelin e saj personalitete të këngës dhe kulturës jo vetëm shqiptare, por mbarëkombëtare, ku mund të veçojmë këngëtarët e mëdhenj shkodran si: Bik Ndoja, Shyqyri

Alushi, Bujar Qamili „Mjeshtri i Madh“, këngëtarët mbretëresha Mukades Çanga, Violeta Zefi, Vjollca Luka, si dhe shumë të tjerë këngëtarë të njohur si, Artiola Toska, Stresi, Nojzi, Greta Koçi, Ingrid Gjoni, Sinan Hoxha, legjendat e këngës kosovare Ismet Peja e Shkurte Fejza, duke vijuar me grupe dhe këngëtarë të tjerë nga Kosova si: „Xhevahirët“, „Lirikët“, „Okarina“, „Bitionia“, „Vllezërit Mziu“ e shumë të tjerë.

Gjithashtu nga trevat shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi: Xheza e Zyber Avdiu, nga Ulqini: Shaban Gjeka, Haxhi Zeneli, Gëzim Salaj, Vesel Pelinku, nga Tuzi: Gjyste Vulaj e Nikoll Nikprela.

„Eëekend vip“ nuk është mjaftuar vetëm me promovimin përmes ekranit të „Blue Sky“ të figurave të shquara të këngës shqipe, por një natë të bukur shtatori mbërtheu para ekranit dashamirësit e humorit shkodran kur pjesë e këtij formati për orë të tëra bëri artistin e madh Paulin Preka.

Puna e kësaj drejtuese atë natë ishte më e vështirë se herë të tjera, por ajo ia doli mbanë sepse paneli aq i mrekullueshëm ia bëri punën më të lehtë.

Për këtë natë me gaz e humor, me të ftuar të mrekullueshëm dhe me një ilustrim muzikor tipik shkodran na dha vlerësimet e tia studiuesi i kulturës dhe i muzikës shkodrane, Isa Alibali, i cili më së tepërmi u ndal te kjo drejtuese që natyrisht mbajti edhe peshën më të madhe të emisionit.

„Më la shumë mbresa aftësia drejtu-

ese e Adelajda Tukiqit, u shpreh Isa Alibali. Kam mendimin se, megjithëse e re, i plotëson mirë kërkesat që ka teleshikuesi për një drejtim cilësor të emisioneve. Duke qenë që ka kulturën e duhur për një detyrë të tillë edhe pse është e re dhe në hapat e parë. Mendoj se të gjitha komponentët e duhur si: mënyra e shprehjes, paraqitja, zëri, diksioni, mimika dhe plastika, shpejt mund ta bëjnë një prezantuese dinjitoze dhe me nivel. Për këtë duhet shumë punë dhe përkushtim, për ta zotëruar sa më mirë ekranin dhe ritmin e emisionit“.

Si një zonjë shtëpie Adelajda Tukiqi i pret e i „sejdis“ gjithmonë me dashamirësinë që e karakterizon, por edhe me nivelin e lartë profesional të bashkëbisedimit në mënyrë që kjo „tribunë“ të bëhet përçuese e vlerave kulturore dhe artistike, si një mision që ka marrë përsipër Art Center „Blue Sky“.

Ky program tanimë është ndër programet më të ndjekur të këtij TV, sepse në çdo fundjavë në panelin e kësaj skene ulen personalitete të kulturës dhe muzikës shqiptare të denjë për emërtimin „Very important persons“.

E veçanta nga programi në program është se në këtë panel kanë marrë titullin „Vip“ edhe talente të rinj, që natyrisht janë vazhdimësia më e zgjedhur e traditës si: Marije Lajçaj, Albana Mesuli, Eli Malaj, Njomza Hyseni, Nikoleta Vokri, Blerta Cinaj, Anjeza Ndoj e te tjere.

Nga RAMAZAN ÇEKA